



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 29/2023 regjistër (JR)
Datë 12.07.2023

Nr. 55 i vendimit
Datë 16.07.2025

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Albana Shtylla	Kryesuese
Natasha Mulaj	Relatore
Mimoza Tasi	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, më datë 16.07.2025, ditën e mërkurë, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretare Gjyqësore Ina Xhetani, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Sokol Malaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 659, datë 12.05.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni F i Aneksit të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; nenet 42 dhe 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; nenet 1, 2, 63 dhe 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; neni 6 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit dhe

parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes, Natasha Mulaj, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit Sokol Malaj (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), në funksion të zhvillimit të procesit të rivlerësimit kalimtar, bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, administroi raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”), me këto konstatime:

2.1. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, pasi kreu procedurën e kontrollit të hollësishtëm të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera dërgoi pranë Komisionit aktin e përfundimit të këtij kontrolli¹, me konstatimet se: (i) *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin*; (ii) *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë*; (iii) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë*; (iv) *nuk ka kryer deklarim të rremë*; (v) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave*.

2.2. DSIK-ja, në zbatim të nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të procesit të kontrollit të figurës së subjektit të rivlerësimit, pas përfundimit të procedurave të kryera nga Grupi i Punës, fillimisht dërgoi raportin² në të cilin konstatoi *përshatshmëri për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Sokol J. Malaj*. Pas kërkesës së Komisionit, DSIK-ja dërgoi raportin e përditësuar nr. {***} prot., datë 01.02.2023³, sipas së cilit disponohen të dhëna mbi përfshirjen e subjektit të rivlerësimit në veprimtari të kundërligjshme. Në përfundim të raportit, konkludohet se: *“Në konfirmim të konstatimit fillestar për përshatshmëri në vijimin e ushtrimit të detyrës për subjektin e rivlerësimit Sokol J. Malaj, gjykojmë që për rastin në fjalë konkluzioni të mbetet në vlerësimin tuaj, nën dritën e informacioneve të tjera që mund të dispononi si pjesë e gjetjeve/konstatimeve të dala nga procedurat e hetimit administrativ, që po kryhen ndaj subjektit të rivlerësimit”*.

2.3. KLP-ja, pasi ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, bazuar në përshkrimin dhe analizimin e formularit të vetëdeklarimit, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, të dhënave e dokumenteve që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të pesë dosjeve penale, të përzgjedhura sipas një sistemi

¹ Me shkresën nr. {***} prot., datë 07.12.2018, “Dërgohet akti i përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Sokol Malaj, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë”.

² Shkresa nr. {***} prot., datë 02.11.2017, “Dërgohet raporti mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Sokol J. Malaj”, deklasifikuar plotësisht nga Komisioni i Deklasifikimit dhe i Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror” (KDZh), me vendimin nr. {***}, datë 14.10.2022.

³ Raporti i deklasifikuar pjesërisht nga KDZh-ja me vendimin nr. {***}, datë 08.03.2023.

objektiv dhe rastësor, si dhe të dhënave nga prokuroritë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Drejtorisë së Përgjimeve të Telekomunikimit dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informative dhe Zyrës së Informacionit të Klasifikuar, Sektori i Protokoll-Arkivit, si dhe burimeve arkivore të Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun në Prokurorinë e Përgjithshme, i ka përcjellë Komisionit një raport⁴ të hollësishëm dhe të arsyetuar, për aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit Sokol Malaj.

3. Komisioni kreu një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret e rivlerësimit, vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale dhe, në përfundim të procesit të rivlerësimit, mori vendimin nr. 659, datë 12.05.2023.

4. Vendimin nr. 659, datë 12.05.2023, për “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Sokol Malaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”, Komisioni e ka bazuar në nenin 61, pikat 3 dhe 5, si dhe nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, mbështetur në këto konkluzione:

i. Lidhur me kriterin e pasurisë, rezultoi se subjekti ka paraqitur në mënyrë të pasaktë marrëdhënien e interesit pasuror me vëllain e tij dhe nuk arriti të provonte të kundërtën e barrës së provës në lidhje me krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve me burime të ligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3 dhe 5 e Aneksit të Kushtetutës, duke rezultuar me mungesë burimesh financiare të ligjshme në shumën 10.218.055 lekë, për vitet 2011, 2012 dhe 2016, sipas nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

ii. Lidhur me pjesëmarrjen e subjektit në veprimtarinë tregtare dhe mbajtjen e aksioneve aktive edhe pas ndalimeve ligjore sipas ligjit nr. 96/2016, trupi gjykues çmon se veprimet e subjektit kanë prodhuar mospërputhje thelbësore me funksionin e prokurorit dhe detyrimet në lidhje me etikën. Sjelljet e subjektit kundrejt detyrimeve ligjore konsiderohen nga trupi gjykues si fakte të çështjes që janë të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk mund të gëzojë besimin e publikut për të qëndruar në detyrë, sipas nenit 61/5 të ligjit nr. 84/2016.

iii. Lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, referuar nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

iv. Lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale [...] subjekti arrin nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016. Mangësitë e evidentuara në rastet e denoncimeve të trajtuara në këtë vendim, nuk janë të mjaftueshme për ta konsideruar subjektin të papërshtatshëm sipas nenit 44, germa “c”, por në raport dhe me gjetjet e tjera, duhen vlerësuar dhe trajtuar si situata, të cilat ndikojnë në cenimin e besimit të publikut, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

v. Lidhur me vlerësimin tërësor të çështjes, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, në zbatim të neneve 61, pika 5 dhe 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit.

⁴ Me shkresën nr. {***} prot., datë 13.02.2023, “Raport për vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Sokol Malaj”.

II. Shkaqet e ankimit

5. Kundër vendimit nr. 659, datë 12.05.2023, të Komisionit, ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit Sokol Malaj, i cili, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, ka kërkuar ndryshimin e këtij vendimi dhe konfirmimin e tij në detyrë, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Subjekti i rivlerësimit e ka konsideruar vendimin e Komisionit të dhënë në kundërshtim me provat e administruara dhe në interpretim të gabuar të ligjit, në shkelje të nenit 57 dhe nenit 61, pikat 3 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016, të neneve A, Ç, D, Dh, E, Ë të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 6, 8 dhe 13 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut. Shkaqet e ankimit, si për zbatueshmërinë e dispozitave kushtetuese dhe ligjore të procesit të rivlerësimit kalimtar, ashtu edhe themelit të çështjes, do të evidentohen dhe do të vlerësohen në vijim në këtë vendim.

III. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Shqyrtimi i çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

6. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2, të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji i Posaçëm i Apelimit (në vijim “Kolegji”) ka juridiksion *ratione materiae* ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit për rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4, të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit Ë, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Sokol Malaj, vendim të cilin, nëpërmjet ankimit, subjekti i rivlerësimit kërkon ta ndryshojë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas parashikimit të nenit 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

7. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

8. Në përputhje me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i çështjes në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, kryhet në dhomë këshillimi. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, për shqyrtimin e vendimit nr. 659, datë 12.05.2023, të Komisionit, nëpërmjet ankimit të subjektit të rivlerësimit Sokol Malaj, u mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, të zhvilluar në datën 16.07.2025.
9. Trupi gjykues i Kolegjit, fillimisht, analizoi shkaqet e ankimit të ngritura nga subjekti i rivlerësimit, që kanë të bëjnë me interpretimin dhe zbatueshmërinë e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, nga Komisioni, duke vlerësuar si vijon:

9.1. Në ankim, subjekti i rivlerësimit pretendon se, në kuadër të kriterit të vlerësimit të pasurisë, nga interpretimi i nenit D të Aneksit të Kushtetutës, legjislatori ka parashikuar shkarkimin nga detyra, në rastet kur subjekti i rivlerësimit: (i) ka një pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme; (ii) nuk dorëzon brenda afatit ligjor deklaratën *vetting* dhe (iii) përpiqet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë. Subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk plotëson asnjë nga shkaqet kushtetuese për shkarkimin nga detyra, lidhur me këtë kriter.

9.1.1. Trupi gjykues, nga analizimi i vendimit objekt shqyrtimi, konstaton se Komisioni ka marrë masën disiplinore të shkarkimit nga detyra, pasi ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në mënyrë të pasaktë marrëdhënien e interesit pasuror me të vëllain dhe nuk arriti të provonte të kundërtën e barrës së provës në lidhje me krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve me burime të ligjshme, në kuptim të nenit D, pikat 3 dhe 5, të Aneksit të Kushtetutës, duke rezultuar me mungesë burimesh financiare të ligjshme, sipas nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016. Po kështu, përveç nenit 61, pika 3 e këtij ligji, Komisioni ka gjetur të mjaftueshme problematikat si në kuadër të pjesëmarrjes së subjektit të rivlerësimit në veprimtarinë tregtare dhe mbajtjen e aksioneve, ashtu edhe mangësitë profesionale të rezultuara nga analizimi i çështjeve penale të sjella në vëmendje në kuadër të denoncimeve, për të zbatuar edhe një shkak tjetër të pavarur shkarkimi nga detyra, atë të parashikuar nga neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Përcaktimet e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, janë transpozuar në parashikimet e ligjit të posaçëm nr. 84/2016, i cili në nenin 61, pikat 1 dhe 3 të tij, parashikon rastet e shkarkimit nga detyra në kuadër të kriterit të vlerësimit të pasurisë, kriter për të cilin mund të bëhet i zbatueshëm dhe neni 61, pika 5 e këtij ligji, në rastet kur veprimet e ndërmarra nga subjekti cenojnë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

9.1.2. Ndonëse subjekti i rivlerësimit në ankim ka bërë edhe një interpretim të konceptit të *dyfishit* të pasurisë së ligjshme të parashikuar nga neni D, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës dhe neni 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016,⁵ me pretendimin se ligjvënësi ka synuar të orientojë organet e rivlerësimit në aplikimin e standardit të dyfishit të pasurisë së ligjshme, si kufi ndarës për përgjegjësinë disiplinore, dhe se ai nuk gjendet në këto kushte, Kolegji ka tashmë një qëndrim të konsoliduar në jurisprudencën⁶ e tij, se secili nga paragrafët e nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, paraqet një situatë ligjore që përbën shkak autonom për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Në këto kushte, objekt i analizës në Kolegji është vlerësimi nëse konkluzioni i arritur nga Komisioni, se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e nenit 61, pikat 3 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016, është i drejtë ose i gabuar.

9.2. Subjekti i rivlerësimit pretendon se ka plotësuar detyrimin kushtetues të provueshmërisë së burimit të ligjshëm të krijimit të pasurive të deklaruara prej tij dhe të personave të lidhur me të, dhe nuk gjendet në situatën e parashikuar nga neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016. Ai pretendon se ka kryer deklaratime të sakta, të cilat e përjashtojnë nga gjendja e parashikuar nga neni 33, pika 5, shkronjat “c” dhe “ç” të ligjit nr. 84/2016. Ky pretendim i subjektit të rivlerësimit do të vlerësohet nga trupi gjykues gjatë analizimit të shkaqeve të ankimit që i përkasin kriterit të vlerësimit

⁵ Neni D, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës parashikon: “Nëse subjekti i rivlerësimit ka një pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme, ai prezumohet fajtor për shkëlqen disiplinore, përveçse kur ai paraqet prova që vërtetojnë të kundërtën”. Neni 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, parashikon se: “Shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit jepet si masë disiplinore në këto raste: 1. Kur rezulton se ka deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme gjatë vlerësimit të pasurisë, përfshirë edhe personat e lidhur me të”.

⁶ Shih ndër të tjera vendimin nr. 19 (JR), datë 26.07.2019, paragrafi 22.15, dhe vendimin nr. 39, datë 25.09.2023, paragrafi 16.1, të Kolegjit.

të pasurisë. Megjithatë, interpretimi mbi zbatueshmërinë e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, gjendet i shtjelluar gjerësisht në jurisprudencën e Kolegjit, në drejtim të thirrjes për aplikim të kësaj dispozite, si pasojë e konstatimit të subjektit të rivlerësimit në një apo disa nga situatat e parashikuara nga ky ligj, përkatësisht në nenin 33, pika 5, shkronjat “b”, “c”, “ç” apo “d” të tij.

9.3. Në ankim, subjekti i rivlerësimit pretendon gjithashtu se, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, përbën shkak ligjor për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, nëse plotësohen në mënyrë kumulative dhe jo alternative, pamjaftueshmëria në kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe në kriterin e kontrollit të figurës. Mosplotësimi i njërit kusht bën që konkluzioni i Komisionit, i bazuar në këtë dispozitë, të jetë haptazi i pambështetur në ligj. Për pasojë, rezulton një mospërputhje e arsyetimit në vendimin e Komisionit dhe referencës ligjore të përdorur për shkarkimin nga detyra të subjektit.

9.3.1. Subjekti i rivlerësimit e vijon argumentin në këtë pikë me pretendimin se, jo pa arsye, ligjvënësi ka lidhur këto dy kritere në mënyrë të njëkohshme në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, pasi pasaktësisht që mund të konstatohen në kriterin e vlerësimit të pasurisë duhet të jenë të lidhura me indicie për veprime të paligjshme gjatë ushtrimit të detyrës, të cilat analizohen në kuadër të kriterit të kontrollit të figurës, në mënyrë që të përlligjin shkarkimin nga detyra të subjektit sipas kësaj dispozite. Jo çdo pasaktësi e konstatuar në lidhje me vlerësimin pasuror duhet të përbëjë shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, në të kundërt, nëse do të kishte pasur këtë qëllim, ligjvënësi nuk do t'i rendiste ato si kritere kumulative në nenin 61, pika 3 e ligjit, por si kritere alternative ose shkaqe të pavarura, që çojnë në shkarkim nga detyra.

9.3.2. Trupi gjykues edhe për këtë pretendim, në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, sjell në vëmendje se Kolegji ka një qëndrim të konsoliduar në jurisprudencën e tij, sipas së cilit vlerësimi i kriterit të pasurisë dhe i pastërtisë së figurës mund të çojë në mënyrë të pavarur në pasojat e parashikuara nga ky nen, nëse deklarimi i subjektit të rivlerësimit për kriterin objekt shqyrtimi vlerësohet i pamjaftueshëm. Pavarësisht se deklarimi i pamjaftueshëm i pasurisë dhe i figurës janë parashikuar në të njëjtën dispozitë ligjore bazuar në përcaktimet e neneve D dhe Dh të Aneksit të Kushtetutës, për këto dy kritere, nuk mund të pretendohet se aplikimi i tyre duhet të interpretohet në mënyrë kumulative. Përcaktimet në pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, nuk kërkojnë domosdoshmërisht vlerësimin për të dy kriteret bashkërisht për të konkluduar që subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm. Po ashtu interpretohen përcaktimet e këtij neni edhe në raport me ato të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, të cilat për konfirmimin në detyrë të subjektit kërkojnë plotësimin së bashku të kushteve për të tria kriteret e rivlerësimit. Me këtë logjikë arsyetimi, nëse subjekti nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë, edhe pse vlerësimi për dy kriteret e tjera është pozitiv, institucionet e rivlerësimit disponojnë me masën disiplinore të shkarkimit nga detyra. Sa më sipër, pretendimi e subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

10. Lidhur me formën e shqyrtimit të çështjes, trupi gjykues, bazuar në analizën më sipër, vlerëson se nuk gjendet në asnjë nga rastet e parashikuara nga neni 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, që do të legjitimonte kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore publike dhe, për rrjedhojë, vijoi shqyrtimin e kësaj çështjeje në seancë gjyqësore, në dhomën e këshillimit, mbi bazë të akteve, sipas parashikimeve të nenit 49 të këtij ligji.

B. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë

*B/1 - Për pasurinë “tokë” (kullotë), me sipërfaqe 1000 m² (zonë e pamenaxhuar), {***}, Palasë, Vlorë në bashkëpronësi me vëllain A. M., blerë me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.06.2011, në vlerën 200.000 lekë*

11. Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare në shumën 427.878 lekë të investonte në këtë pasuri, të kursente, si dhe të përballonte shpenzimet e tjera familjare për vitin 2011, duke u gjendur në kushtet e parashikuara në nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, që është vlerësuar në tërësi me rrethanat e çështjes, të cilat janë përcaktuese për vlerësimin e kriterit të pasurisë.
12. Subjekti i rivlerësimit kundërshton këtë konkluzion, me pretendimet se Komisioni: (i) nuk ka marrë në konsideratë faktin që shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit zyrtar në Madrid, Spanjë, në datat 29.11.2011 – 02.12.2011, në vlerën 330 euro, për pjesëmarrjen në seminarin me temë “Suport për sistemin juridik shqiptar për krimin mjedisor”, janë mbuluar nga organizatorët, Qendra Rajonale për Ambientin për Evropën Qendrore dhe Lindore; (ii) arsyetimin për llogaritjen e gjendjes së likuiditeteve (në bankë dhe *cash*) për vitin 2011, nuk e ka bazuar në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, duke i interpretuar ato në mënyrë të njëanshme dhe të gabuar.
13. Nga analizimi i akteve të administruara në dosjen gjyqësore të Komisionit, trupi gjykues analizon dhe vlerëson si vijon:
 - 13.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Sipërfaqe toke (kullotë) prej 1000 m² (zonë e pamenazhuar) {***}, Vlorë në bashkëpronësi me vëllain A. M., blerë me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.06.2011, në vlerë 200.000 lekë. Burim janë të ardhurat e realizuara nga biznesi Klinikë Dentare. Pjesa takuese 1/2*”.
 - 13.2. Kontrata e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.06.2011, rezulton e nënshkruar mes palës shitëse L. V. dhe palës blerëse A. M. dhe Sokol Malaj, kundrejt shumës 200.000 lekë, të likuiduar tërësisht jashtë zyrës noteriale. Për herë të parë, pasuria është deklaruar në deklaratën periodike vjetore 2011, por pa deklaruar burimin e krijimit të saj.
 - 13.3. Gjatë hetimit administrativ, me përgjigjet e pyetësorit nr. 3, subjekti i rivlerësimit është shprehur se mosdeklarimi i burimit të krijimit në deklaratën periodike të vitit 2011 ka qenë një harresë e tij dhe sqaron se në deklaratën e pasurisë *vetting* e ka deklaruar saktë këtë pasuri dhe burimin e krijimit të saj, që konsiston në kursime familjare dhe të ardhura nga aktiviteti tregtar i bashkëshortes, klinikë dentare.
 - 13.4. Nisur nga deklarimi se burimi i krijimit kanë qenë të ardhurat nga biznesi i bashkëshortes në profesionin e stomatologes, Komisioni, pas analizimit të shkresës nr. {***} prot., datë 19.01.2017, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, pjesë e dosjes së ILDKPKI-së, ka konstatuar se të ardhurat nga ky aktivitet për vitin 2011 rezultojnë në vlerën 3.217.920 lekë, të mjaftueshme për të mbuluar investimin në shumën 100.000 lekë, për blerjen e pjesës takuese të kësaj pasurie. Përpos kësaj, Komisioni ka kryer edhe analizën financiare për vitin 2011, rezultatet e së cilës kanë treguar mungesë burimesh financiare të ligjshme në shumën (-) 533.677 lekë, në rezultatet e hetimit administrativ, të reduktuar në (-) 427.878 lekë, në vendimin përfundimtar të tij.

- 13.5. Subjekti i rivlerësimit, si në shpjegimet e dhëna në Komision, ashtu edhe në ankim, ka kundërshtuar mosmarrjen në konsideratë të faktit se shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit zyrtar në Madrid, Spanjë, në datat 29.11.2011 – 02.12.2011, në vlerën 330 euro, me qëllim pjesëmarrjen në një seminar të organizuar nga Qendra Rajonale për Ambientin për Evropën Qendrore dhe Lindore, me temë “Suport për sistemin juridik shqiptar për krimin mjedisor” janë mbuluar nga organizatorët. Subjekti ka sqaruar se në atë kohë ka udhëtuar së bashku me 3 (tre) kolegë të tjerë, në cilësinë e prokurorit dhe drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- 13.6. Komisioni, në kuadër të hetimit administrativ, i ka kërkuar informacion Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, lidhur me udhëtimet e subjektit të rivlerësimit të kryera për qëllime pune jashtë vendit, gjatë periudhës që ka ushtruar funksionin e prokurorit pranë kësaj prokurorie. Me shkresën nr. {***} prot., datë 08.06.2021, kjo prokurori vë në dispozicion dokumentacionin e kërkuar, përcjellë nga Prokuroria e Përgjithshme, nga i cili nuk evidentohen të dhëna lidhur me udhëtimin e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit.
- 13.7. Komisioni nuk e ka marrë në konsideratë pretendimin e subjektit të rivlerësimit, me arsyetimin se ai nuk provoi pjesëmarrjen e tij në këtë trajnim, pasi nga dokumentacioni i administruar nuk identifikohet emri apo pjesëmarrja e tij, dhe se marrëveshja e depozituar për këtë vizitë studimore referon si përfitues vetëm një prokuror tjetër, si dhe konfirmon vetëm biletën e udhëtimit të këtij të fundit.
- 13.8. Nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore të administruara në Komision, rezulton që të dhënat në biletën e udhëtimit të një prej pjesëmarrësve në këtë seminar (data/ora/destinacioni i fluturimit tranzit/pika e kalimit kufitar) përputhen me të dhënat e sistemit TIMS mbi hyrje-daljet në Republikën e Shqipërisë të subjektit të rivlerësimit, të vëna në dispozicion nga Drejtoria e Policisë së Shtetit, me shkresën nr. {***} prot., datë 21.05.2021, gjë që tregon se subjekti i rivlerësimit ka udhëtuar me kolegun e tij si në nisje dhe në kthim, por nuk provohet me dokumentacion justifikues që ky udhëtim i subjektit të jetë kryer në kuadër të funksionit/punës në seminarin e sipërcituar. Në këto kushte, kur pjesëmarrja e subjektit në këtë aktivitet nuk është konfirmuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me shkresën nr. {***} prot., datë 08.06.2021, trupi gjykues mbajti qëndrim të njëjtë me Komisionin, lidhur me këtë pretendim të subjektit, ndonëse efekti financiar i shpenzimeve të këtij udhëtimi, prej 45.639 lekësh, është tërësisht pa peshë në raport me situatën financiare në tërësi të subjektit të rivlerësimit.
14. Për llogaritjen e gjendjes së likuiditeteve (në bankë dhe *cash*) për vitin 2011, Komisioni në vendim ka vlerësuar se pretendimi i subjektit nuk qëndron, pasi gjatë hetimit administrativ, me përgjigjet e pyetësorit nr. 3, lidhur me kursimet e tij *cash*, ka rikonfirmuar deklaratimet në deklaratat periodike vjetore, në të cilat kursimet *cash* për vitin 2011 kanë qenë në vlerën 4.200.000 lekë dhe, në asnjë rast, nuk ka deklaruar se në këtë shumë përfshihen edhe likuiditetet në sistemin bankar. Sipas Komisionit, edhe nëse merret në konsideratë pretendimi i subjektit të rivlerësimit, *gjendja cash e akumuluar nuk do të përputhet me: (i) deklaratimet periodike të subjektit; (ii) deklarin e tij në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI; (iii) deklarimin e tij gjatë hetimit administrativ; si dhe (iv) shumën e përdorur në vitet në vijim si burim krijimi për huan apo investimet e kryera. Ky ndryshim i deklaratimit nga ana e subjektit për kursimet e tij cash duket se pretendohet vetëm për të përmirësuar situatën financiare pas dërgimit të rezultateve të hetimit.*

15. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni nuk e ka bazuar arsyetimin në deklaratimet e tij, duke i interpretuar ato në mënyrë të njëanshme dhe të gabuar. Veprimi i Komisionit, për të shtuar 385.142 lekë mbi shumën e deklaruar, ka ndikuar negativisht në pamundësinë financiare që i rezulton Komisionit për vitin 2011. Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues konstaton se:

15.1. Në deklaratën periodike vjetore 2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Shuma të kursyera nga paga ime si drejtues i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, 1.200.000 lekë, shuma të kursyera nga aktiviteti privat i bashkëshortes, Klinikë Dentare, 3.000.000 lekë”*. Në këtë deklaratë, subjekti nuk deklaron gjendje likuiditeti në bankë.

15.2. Nga analizimi i deklaratave periodike vjetore konstatohet se subjekti i rivlerësimit: (i) Në deklaratën e vitit 2005 deklaron të ardhura nga paga të kursyera *cash*, në vlerën 630.000 lekë, një pjesë të të cilave e ka në banesë dhe 300.000 lekë dhënë hua kushëririt, L. M. (ii) Deri në vitin 2008, nuk deklaron shtesa/pakësime të likuiditeteve. (iii) Në deklaratën periodike të vitit 2010, rezulton të ketë deklaruar gjendje *cash* në shumën 2.350.000 lekë të kursyer nga të ardhurat e aktivitetit të bashkëshortes në vitin 2009 dhe kursime *cash* 4.150.000 lekë në vitin 2010, në total 6.500.000 lekë, kursime *cash* këto, që deklaron t’ia ketë dhënë hua të vëllait. Për pasojë, në fund të vitit 2010, gjendja e likuiditeteve *cash* ka qenë zero lekë. Pra, rezulton që subjekti të ketë deklaruar kursime *cash* vetëm në vitet 2005 dhe 2010.

Në vitet 2011, 2013 dhe 2014, subjekti i rivlerësimit deklaron në mënyrë konstante kursime, ndërkohë që nuk specifikon nëse janë gjendje *cash* në banesë apo likuiditet në bankë. Në këto kushte, rezulton që për këtë periudhë, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në përputhje me kërkesat e nenit 4, shkronja “d” e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, *“Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”*, i ndryshuar, që parashikon se subjektet detyrohen të deklarojnë gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës: *“d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në cash jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj”*. Në kuptim të kësaj dispozite, subjekti i rivlerësimit duhet të deklaronte më vete likuiditetet gjendje në *cash* jashtë sistemit bankar dhe ato të ndodhura në sistemin bankar.

Në vitin 2012, subjekti deklaron: *“Kursime nga paga dhe fitimi i realizuar nga aktiviteti privat “klinikë dentare”, 5.300.000 lekë, statement Credins Bank”*, ndërsa në vitin 2015, deklaron: *“Kursime nga paga dhe fitimi i realizuar nga aktiviteti privat “klinikë dentare”, fitimi nga dividendi për vitin 2014 dhe shitja e 50% të aksioneve të shoqërisë “{***}” ShPK, 821.468 lekë, llogari rrjedhëse Credins Bank, 12.000.000 lekë në depozitë me afat 1-vjeçar, Credins Bank”*.

15.3. Referuar procesverbalit të mbajtur nga ILDKPKI⁷, më datë 09.02.2016, në kuadër të kontrollit të ushtruar nga ky institucion, i pyetur se përse nuk janë deklaruar prej tij gjendjet e mbetura (shtesa/pakësime) në llogarinë rrjedhëse në Raiffeisen Bank ShA, për periudhën 2005 – 2014, përveç vitit 2008, subjekti i është përgjigjur se: *ka qenë korrekt në deklarimin e të ardhurave nga paga që janë burim i kësaj llogarie dhe se gjendjet e mbetura nuk kanë qenë në vlera të konsiderueshme, dhe për më tepër në sistemin bankar*. Ndërsa pyetjes për të përcaktuar gjendjen *cash* në fund të vitit 2014, subjekti i rivlerësimit i është përgjigjur se: *gjendja cash është deklaruar vit pas viti dhe në fund të vitit 2014 ka qenë rreth 15.300.000 lekë. Pjesa më e madhe e saj është përdorur gjatë vitit 2015 dhe në janar 2016, për blerjen e dy apartamenteve, arredimin e tyre, një garazh dhe një makinë*.

⁷ Përcjellë nga ILDKPKI-ja me shkresën nr. {***} prot., datë 09.10.2020.

15.4. Për të saktësuar ndryshimin e gjendjes *cash* në banesë dhe likuiditeteve në bankë, Komisioni, pasi ka hartuar një pasqyrë të kursimeve sipas deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore 2005 – 2015, me pyetësin nr. 3, i ka kërkuar shpjegime atij për të qartësuar gjendjen e kursimeve *cash*, në fund të çdo viti. Subjekti i përgjigjet sipas deklarimeve në deklaratat periodike vjetore, duke saktësuar se në vitin 2010 është sqaruar fakti që: “në vitin 2009 kam deklaruar të ardhura nga aktiviteti privat i bashkëshortes, në shumën 2.350.000 lekë. Kjo shumë është kursyer e gjitha në gjendje *cash*”. Pra, vlera prej 2.350.000 lekësh ishte kursyer *cash* në vitin 2009. Ndërsa në vitin 2010, rezulton të jetë kursyer *cash*, vlera prej 4.150.000 lekësh, si diferencë e vlerës 6.500.000 lekë me 2.350.000 lekë.

15.5. Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni ka konstatuar se analiza financiare e vitit 2011 rezulton me balancë negative prej (-) 533.677 lekësh dhe, në këtë analizë, ndryshimi i gjendjes së likuiditetit në raport me vitin e mëparshëm (31.12.2010), është përlllogaritur 4.553.008 lekë. Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet mbi barrën e provës, ka shpjeguar se deklarimi i bërë në vitin 2011, për kursimet dhe pasuritë, është i qartë. Shumat e kursyera në likuiditet janë vetëm 4.200.000 lekë, të cilat përfshijnë edhe vlerat e ndodhura në bankë në fund të vitit 2011, prej 385.142 lekësh. Kjo shumë përfshihet në vlerën e deklaruar dhe nuk duhet t'i shtohet asaj, duke ndikuar negativisht në pamundësinë financiare që i rezulton Komisionit për këtë vit.

15.6. Trupi gjykues i Kolegjit, nga analizimi i dokumentacionit bankar të administruar në dosjen e Komisionit, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka pasur gjendje në llogaritë e tij bankare prej vitit 2005 e në vijim, ndërsa bashkëshortja prej vitit 2004 e në vijim, dhe si subjekti i rivlerësimit ashtu dhe bashkëshortja, nuk rezultojnë të kenë deklaruar ndryshimet e gjendjes e likuiditeteve në bankë, në deklaratat periodike vjetore, përveçse në deklaratën e vitit 2016. Praktikë kjo e evidentuar edhe nga Komisioni, në vendim objekt shqyrtimi, se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* 3 (tre) llogari të disponuara në Raiffeisen Bank ShA dhe Credins Bank ShA, për të cilat ka çmuar se përbëjnë pasaktësi në deklarim dhe që nuk ngrihen si shkak për penalizim në këtë proces⁸. Ndërkohë që nga analizimi i këtij dokumentacioni ka rezultuar se balanca e llogarive bankare të tyre, në fund të vitit 2011, të jetë shtuar me rreth 353.000 lekë, kundrejt fundvitit të mëparshëm.

15.7. Nisur nga rrethana të tilla si: a) në deklaratën periodike vjetore 2011, subjekti deklaroi shumën e kursyera nga paga e tij, prej 1.200.000 lekësh, dhe shumën e kursyer nga aktiviteti privat i bashkëshortes, prej 3.000.000 lekësh, në total 4.200.000 lekë, pa specifikuar nëse këto kursime janë gjendje *cash* në banesë apo likuiditet në bankë, praktikë kjo që haset edhe në disa deklarata të tjera periodike vjetore të tij; b) subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore ndryshimin (shtesat/pakësimet) e gjendjes së likuiditeteve në llogaritë bankare në fund të çdo viti krahasuar me atë të vitit paraardhës, si dhe c) konfuzioni në deklarimet dhe paqartësitë në shpjegimet e dhëna prej tij gjatë hetimit administrativ lidhur me gjendjen *cash*, në fund të çdo viti deklarues, trupi gjykues, ndryshe nga Komisioni, i ka konsideruar likuiditetet në fund të vitit 2011 në vlerën totale 4.200.000 lekë, *cash* dhe në bankë. Me fjalë të tjera, Kolegji në kontrollin e analizës financiare të Komisionit, gjendjen e likuiditetit *cash*, në fund të vitit 2011, e ka konsideruar për pasojë në vlerën 3.847.000 lekë dhe atë në bankë në vlerën 353.000 lekë.

⁸ Shih paragrafët 29 – 29.6 të vendimit nr. 659, datë 12.05.2023, të Komisionit.

15.8. Në vijim të këtij argumenti, për periudhën në vijim, bazuar në deklaratat periodike dhe gjatë hetimit administrativ, gjendja e likuiditeteve *cash* në fund të vitit 2015, për pasojë nuk mbetet 6.000.000 lekë, sa e pretendon subjekti i rivlerësimit, por në shumën 5.778.650 lekë. Megjithatë, nisur nga fakti që për vitin 2015, analiza financiare e Komisionit rezultoi me tepicë (+) 1.685.222 lekë, konsiderohet e mjaftueshme për të mbuluar diferencën prej 221.350 lekësh dhe për të llogaritur pas këtij veprimi, kursimet *cash* në fund të vitit 2015, në shumën 6.000.000 lekë. Pavarësisht kësaj, siç do të trajtohet në vijim në këtë vendim, mungesa financiare për vitin 2016 (që afektohet nga gjendja *cash* e vitit 2015), ka ardhur si pasojë e mospërfshirjes në mesin e të ardhurave të ligjshme të huas së kthyer nga i vëllai, subjektit të rivlerësimit, në shumën 10.000.000 lekë.

15.9. Për sa arsyetuar më sipër, duke konsideruar si kursime *cash* dhe likuiditet në bankë, shumën e deklaruar 4.200.000 lekë në vitin 2011, trupi gjykues ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme në vlerën (-) 74.878 lekë, për të justifikuar pasurinë “tokë” (kullotë), me sipërfaqe 1 000 m² në {***}, Palasë, kursimet e realizuara dhe shpenzimet e kryera në vitin 2011, duke u gjendur në kushtet e parashikuara në nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

*B/2. Për pasurinë, “apartament banimi me sipërfaqe 96 m² + 51.7 m²”, në vlerën 68.060 euro, si dhe garazh me sipërfaqe 33.2 m², në vlerën 10.715 euro, me adresë: rruga “{***}”, Selitë, blerë me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.01.2016*

16. Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti ka paraqitur në mënyrë të pasaktë marrëdhënien e interesit pasuror me vëllain e tij. Në analizë të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, të cilat rezultuan kontradiktore, si dhe provave të administruara, Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit, pasi nuk shpjegoi bindshëm burimin e krijimit të kësaj pasurie dhe, për pasojë, rezultoi me pamjaftueshmëri financiare në shumën 4.898.521 lekë, për blerjen e saj dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera.
17. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionet e Komisionit për këtë pasuri, me pretendimet se: (i) arsyetimi mbi pamundësinë e subjektit për të shpjeguar bindshëm burimin e krijimit të këtyre pasurive është jo i drejtë dhe vjen si pasojë e keqinterpretimit të akteve provuese të hetuara e administruara nga Komisioni, gjatë hetimit administrativ. (ii) Konkluzioni i Komisionit se, nga kontratat dhe praktikatat e administruara, nuk provohet të jenë gjeneruar të ardhura në favor të vëllait të subjektit të rivlerësimit, përbën interpretim të kundërt dhe të gabuar të akteve të analizuara. (iii) Konkluzioni i Komisionit në lidhje me mosprovimin me ndonjë dokument të faktit se nga shoqëria “{***}” ShPK është kthyer vlera e apartamentit dhe mbetjen e këtij pretendimi në nivel deklarativ, është i gabuar dhe përfaqëson interpretimin e kundërt të provave të sjella nga subjekti i rivlerësimit dhe të administruara nga Komisioni. (iv) Kthimi i shumës në vitin 2016 nga vëllai, nuk përfshihet si detyrim për të provuar burimin e ligjshëm të pasurisë prej 10.000.000 lekësh që ai kthen si huamarrës, te burimi fillestar i kësaj shume, huadhënësi i tyre, i cili në rastin konkret ishte subjekti i rivlerësimit. Qëndrim ky i qartësuar dhe i konsoliduar nga Kolegji në vendimin nr. 20 (JR), datë 03.05.2023, paragrafi 20.20. (v) Në kundërshtim me detyrimin ligjor që ka për të hetuar në tërësi çështjen dhe për t’i dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, duke analizuar dhe cilësuar fuqinë provuese të provave dhe akteve të administruara në hetim, Komisioni nuk ka shqyrtuar për asnjë moment këtë pretendim. Konkluzioni i Komisionit në lidhje me kthimin e huas prej 10.000.000

lekësh nga vëllai, A. M., vjen qartazi në kundërshtim me frymën e ligjit dhe vendimmarrjen në jurisprudencën e Kolegjit.

18. Nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore të administruar në Komision, trupi gjykues konstaton se:

18.1. Në vendimin objekt shqyrtimi të Komisionit, rezulton se mospërfshirja si e ardhur e ligjshme e huas së kthyer nga vëllai i subjektit të rivlerësimit, A. M., prej 10.000.000 lekësh, ka afektuar jo vetëm krijimin e kësaj pasurie, më datë 25.01.2016, por për pasojë, edhe balancën e vitit 2016, analiza financiare e të cilit e ka vendosur subjektin e rivlerësimit në gjendjen e pamundësisë financiare në shumën 9.592.417 lekë, për të investuar në pasuri,⁹ për të shlyer kredinë, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare.

18.2. Për të vijuar me situatën faktike të ofruar nga aktet për pasurinë objekt shqyrtimi, rezulton se në deklaratën e pasurisë vetting, subjekti i rivlerësimit deklaron: “*Apartament banimi me nr. {***} dhe nr. {***}, me sipërfaqe (96 m²+51.7 m²), në vlerën 68.060 euro, si dhe garazh me sipërfaqe 33.2 m², numër pasurie {***}, me vlerë 10.715 euro, me adresë rr. “{***}”, Selitë. [...]. Burimi: të ardhurat të realizuara nga biznesi, klinika dentare në pronësi të bashkëshortes A. M. Vlera 78.775 euro. Pjesa 100%*”.

18.3. Këto pasuri¹⁰ janë përfituar nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.01.2016, të nënshkruar mes shitësit, shoqërisë “{***}” ShPK, dhe subjektit Sokol Malaj në cilësinë e blerësit, me objekt *apartament me sipërfaqe 96 m², kundrejt çmimit 44.230 euro, apartament me sipërfaqe 51.7 m², kundrejt çmimit 23.830 euro, dhe garazh 33.2 m², kundrejt çmimit 10.715 euro*. Çmimi i shitjes së tri pasurive, në total 78.775 euro, është likuiduar sipas dokumentit bankar “*Depozitim për të tretë*”, të lëshuar nga Raiffeisen Bank ShA, më datë 25.01.2016, me urdhërues Sokol Malaj dhe përfitues notere “{***}”, person fizik, me përshkrimin: “*Sokol Malaj blerje apartamenti dhe garazh*”.

18.4. Sa i përket burimit të krijimit, Komisioni ka analizuar të ardhurat e realizuara nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, nga aktiviteti i ushtruar prej saj “*Klinikë Dentare*”¹¹, për periudhën 2009 – 2021, sipas informacionit të vënë në dispozicion nga organet tatimore.¹² Referuar këtyre të dhënave,

⁹ Kjo pamjaftueshmëri financiare rezulton gjatë vitit 2016, pasi përveç pasurive objekt shqyrtimi, subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur: (i) nëpërmjet kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.10.2016, kanë përfituar një apartament tjetër me sipërfaqe 176 m², në vlerën 13.733.000 lekë, si dhe dy garazhe me sipërfaqe 25 m² secili, me vlerë 2.257.500 lekë, ndodhur në rrugën “{***}”, pallati “{***}”, me burim krijimi të deklaruar, 6.000.000 lekë kredi nga Credins Bank ShA, e mbyllur në datën 27.12.2016, pas maturimit të depozitës që ndodhet në këtë bankë, pjesërisht nga të ardhura të realizuara nga biznesi “*Klinikë dentare*”, në pronësi të bashkëshortes dhe pjesërisht fitimi i realizuar nga dividendi si ortak në shoqërinë “{***}” ShPK. (ii) Kanë shlyer këstin prej 10.150 euro të apartamentit 73 m², ndodhur në “{***}”, përfituar nëpërmjet kontratës së porosisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.02.2015 dhe kontratës së shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.07.2016, nënshkruar mes shoqërisë “{***}” ShPK dhe blerëses A. M.

¹⁰ Referuar dokumentacionit të përcjellë me shkresën nr. {***} prot., datë 12.04.2018, të ZVRPP-së Tiranë, në ILDKPKI, dy apartamentet, me nr. {***} dhe nr. {***}, janë bashkuar në një pasuri të vetme, dubleks me nr. pasurie {***}. Këto pasuri janë të regjistruara në emër të subjektit të rivlerësimit.

¹¹ Referuar shkresës nr. {***} prot., datë 27.05.2021, të Qendrës Kombëtare të Biznesit, A. N. M. figuron e regjistruar si person fizik “{***}”, me NIPT {***}, regjistruar më 22.04.2009, me objekt veprimtarie “*Klinikë Dentare*”.

¹² Përcjellë Komisionit me shkresën nr. {***} prot., datë 25.05.2021, të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, dhe shkresën nr. {***} prot., datë 16.03.2023, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë. Shkresën nr. {***} prot., datë 12.01.2023, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, drejtuar znj. A. M., si dhe deklaratat e të ardhurave për periudhën 2009 – 2021, mbi deklarinimin dhe tatimin për të ardhurat personale të biznesit të vogël/deklarimi i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, tek të cilat pasqyrohet qarkullimi vjetor, shpenzimet dhe fitimet e realizuara gjatë këtyre viteve. Statusi i Personit Fizik “{***}” rezulton i pezulluar që prej datës 28.10.2022.

bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka rezultuar me fitim gjatë viteve¹³ të ushtrimit të këtij aktiviteti dhe për periudhën në analizë (2009 – 2016) ka realizuar të ardhura në vlerën 28.210.084 lekë, bazuar në deklaratat e tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël dhe deklaratat e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin. Komisioni nuk konstatoi problematika mbi ligjshmërinë e burimit të krijimit të këtyre të ardhurave, për sa kohë ato burojnë nga aktiviteti tregtar dhe për to janë paguar detyrimet tatimore.

18.5. Nga analizimi i deklaratave periodike vjetore, të ardhurat nga biznesi i bashkëshortes rezultojnë të kenë shërbyer për krijimin e kursimeve të deklaruara, si dhe referuar deklaratës së pasurisë *vetting*, janë deklaruar si burim krijimi për investime në pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme, në vitet 2015 dhe 2016. Po kështu rezulton se këto të ardhura kanë shërbyer edhe për dhënien hua të shumës 10.000.000 lekë, vëllait të subjektit, A. M., në vitet 2010 dhe 2015. Më konkretisht: (i) në deklaratën periodike vjetore 2010, subjekti deklaroi: “*Gjendja cash e krijuar nga të ardhurat e aktivitetit privat të bashkëshortes dhe nga paga ime personale për vitin 2009 – 2010, 6.500.000 lekë. Sqarim: Në vitin 2009, kam deklaruar të ardhura nga aktiviteti privat i bashkëshortes në shumën 2.350.000 lekë. Kjo shumë është kursyer e gjitha në gjendje cash. Shuma e mësipërme, 6.500.000 lekë, i është dhënë borxh, pa interes, vëllait tim, A. M., për qëllime biznesi*”. (ii) Në deklaratën periodike vjetore 2015, subjekti deklaroi: “*Dhënë hua pa interes vëllait tim A. M., për qëllime biznesi, shumën prej 3.500.000 lekë*”. (iii) Në deklaratën periodike vjetore 2016, subjekti i rivlerësimit deklaroi: “*Në muajin tetor 2016, vëllai A. M. më ka kthyer shumën 10.000.000 lekë, të cilën ia kisha dhënë hua ndër vite (nga të ardhurat e krijuara nga klinika e bashkëshortes), shuma e kthyer u përdor për blerjen e apartamentit të deklaruar në pikën nr. 1, të formatit nr. 3*”.

18.6. Në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja, më datë 09.02.2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se *gjendja cash është deklaruar vit pas viti dhe në fund të vitit 2014 ka qenë rreth 15.300.000 lekë. Pjesa më e madhe e saj është përdorur gjatë vitit 2015 dhe në janar 2016, për blerjen e dy apartamenteve, arredimin e tyre, një garazh dhe një makinë.*

18.7. Në kuadër të hetimit administrativ, lidhur me këto hua, me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se i janë dhënë vëllait me qëllim zhvillimin e aktivitetit të tij tregtar. Për shkak të marrëdhënies së posaçme, vlerat monetare janë dhënë e kthyer në *cash*, dhe huaja ka qenë pa interes. Për të provuar shlyerjen e huave, subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.01.2017, të A. M., i cili konfirmon sa deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, si dhe sqaron se shumën totale prej 10.000.000 lekësh ia ka kthyer në muajin janar të vitit 2016.

18.8. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk kishte deklaruar shtesa/pakësime të gjendjes *cash* në deklaratat periodike vjetore 2015 dhe 2016 dhe, për sa kohë në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe atë periodike vjetore 2016, ka deklaruar përdorimin e tyre për investime në pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme, Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 4, i kërkoi të deklaronte gjendjen e kursimeve në *cash* në fund të viteve 2015 dhe 2016, si dhe burimin e krijimit të tyre. Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se në datën 31.12.2014, gjendja *cash* ka qenë 15.000.000 lekë, e krijuar nga kursimet e deklaruara në

¹³ Fitimi pas tatimit, sipas shkresës nr. {***} prot., datë 16.03.2023, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, rezulton për vitin 2009, në vlerën 2.115.002 lekë, për vitin 2010, në vlerën 3.600.000 lekë, për vitin 2011, në vlerën 2.896.128 lekë, për vitin 2012, në vlerën 4.033.577 lekë, për vitin 2013, në vlerën 2.019.859 lekë, për vitin 2014, në vlerën 4.068.265 lekë, për vitin 2015, në vlerën 4.272.055 lekë, për vitin 2016, në vlerën 2.787.732 lekë [...].

deklaratat periodike 2011, 2012, 2013 dhe 2014. Gjatë vitit 2015, gjendja *cash* është pakësuar me 9.000.000 lekë: (i) për përballimin e dhënies së huas vëllait A. M., në vlerën 3.500.000 lekë; (ii) për përballimin e kësteve të paguara për blerjen e apartamentit të shoqëria “{***}” ShPK, në vlerën 30.000 euro, si dhe (iii) për blerjen e automjetit “{***}”, në vlerën 9.000 euro. Në fund të vitit 2015, gjendja *cash* e disponuar është 6.000.000 lekë. Ndërsa gjatë vitit 2016 janë shpenzuar: -- 10.150 euro, për pagesën e fundit të apartamentit të shoqëria “{***}” ShPK; -- 6.200 euro, për plotësimin e vlerës së apartamentit të rruga “{***}”; -- 2.000.000 lekë, për blerjen e apartamentit nga shtetasi F. V.; - pjesa tjetër është shpenzuar për mobilim. Në fund të vitit 2016, gjendja *cash* ka qenë zero lekë.

18.9. Për pyetjen e Komisionit, nëse kishte nënshkruar ndonjë kontratë sipërmarrje/porosie me shoqërinë “{***}” ShPK, përpara kontratës së blerjes, datë 25.01.2016, në përgjigjet e pyetësorit nr. 4, subjekti ka sqaruar se as ai dhe as bashkëshortja, nuk kishin nënshkruar kontratë sipërmarrje/porosie me shoqërinë “{***}” ShPK, përpara kontratës së shitblerjes, së datës 25.01.2016. Marrëdhënia me këtë shoqëri ndërtuese është krijuar nga i vëllai, A. M., i cili ushtron aktivitet në fushën e punimeve të ndërtimit, nëpërmjet një kontrate sipërmarrje (*kleringu*) të datës 10.04.2011. Në vijim dhe mbështetje të argumenteve të tij, subjekti i rivlerësimit depoziton:

18.9.1. Kontratën e sipërmarrjes, datë 10.04.2011 (jonoteriale), nënshkruar mes sipërmarrësit A. M. person fizik dhe porositësit, shoqërisë “{***}” ShPK, me objekt realizimin e punimeve ndërtimore me çmimet përkatëse, sipas zërave të punimeve të përcaktuara në këtë kontratë, në objektet që porositësi zbaton, kundrejt likuidimit të çmimit në mënyrat e rena dakord mes palëve në këtë kontratë. Punimet do të realizohen me materialin e siguruar nga sipërmarrësi, i cili do të kryejë të gjitha llojet e punimeve (lyerje, gips për veshje muresh dhe tavanesh, patinim) në një vlerë totale prej 78.775 euro. Në nenin 4 të kontratës është parashikuar se likuidimi i vlerës do të kryhet 100% me *klering*, me sipërfaqe ndërtimore, apartament dhe post parkimi (apartament dubleks nr. {***}, me sipërfaqe fizike 147.7 m², sipërfaqe e përbashkët 9.2 m² dhe post parkimi nr. {***}, me sipërfaqe 33.2 m²), ndodhur në rezidencën “{***}”, Selitë, Tiranë. Kalimi i objektit të *kleringut* të sipërmarrësit do të kryhet vetëm pasi ai të ketë përmbushur dhe realizuar 100% të vlerës së objektit të kësaj kontrate.

18.9.2. Procesverbal, datë 18.05.2012, i mbajtur nga përfaqësuesi i shoqërisë “{***}” ShPK dhe A. M., për marrjen në dorëzim të apartamentit dhe të garazhit. Sipas shënimit në këtë procesverbal: “Mund të dorëzohet pa u realizuar pagesat dhe pagesat do ndiqen më vonë”.

18.9.3. Marrëveshje “Për miratimin e rregullores së administrimit të pjesë në bashkëpronësi të rezidencës ‘{***}’”, datë 18.05.2012, nënshkruar nga shoqëria administruese “{***}” ShA dhe klienti V. H., për apartamentin dhe postin e parkimit, e disa fatura të pagesave të kryera prej saj, për administrimin dhe mirëmbajtjen e rezidencës, në kohën që jetonte në atë apartament. Sipas shpjegimeve të subjektit, në përgjigje të pyetësorit nr. 4, në këtë apartament ka banuar familja e motrës së tij dhe prindërit e tyre. Ky apartament do të blihej nga familja e motrës, znj. V. H., e cila, ashtu si edhe subjekti i rivlerësimit, ndër vite, kishte huazuar te vëllai A. M. shuma monetare, duke i mundësuar këtij të fundit ushtrimin e aktivitetit të sipërmarrjes së vogël të ndërtimit. Sipas subjektit, familja e motrës ka jetuar në atë apartament deri në vitin 2016 dhe, duke qenë se nuk ranë dakord për blerjen e tij (ndërkohë që ka përfituar po nga marrëdhëniet e *kleringut* të vëllait, apartament tjetër), ky apartament kaloi më pas në pronësinë e subjektit të rivlerësimit, me kontratën e datës 25.01.2016.

18.9.4. “Deklaratë për mbyllje raporti kontraktual, sipas kontratës së sipërmarrjes datë 10.04.2011”, e nënshkruar më datë 26.01.2016, në të cilën palët bien dakord të mbyllin raportin kontraktual sipas kësaj kontrate dhe deklarojnë se nuk kanë detyrime ndaj njëra-tjetrës e se nuk do të kenë asnjë

pretendim në të ardhmen në lidhje me të drejtat e detyrimet e përcaktuara në kontratën e sipërmarrjes së datës 10.04.2011, të nënshkruar ndërmjet tyre.

18.10. Po në përgjigje të pyetësorit nr. 4, lidhur me dokumentacionin justifikues për burimin e krijimit që ka shërbyer për shumën e kthyer nga A. M., subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se i vëllai, për shkak të ushtrimit të aktivitetit të tij tregtar, si sipërmarrës me ekip punëtorësh, ka krijuar në mënyrë të vazhdueshme marrëdhënie *kleringu* me disa shoqëri ndërtimi, si “{***}” ShPK, “{***}” ShPK, “{***}” ShPK etj., duke kryer punime për ndërtimet e realizuara nga këto shoqëri dhe duke përfutur sipërfaqe ndërtimi për njësi, apartamente banimi dhe garazhe. Për të provuar sa sipër, subjekti i rivlerësimit ka depozituar disa kontrata sipërmarrjeje të nënshkruara nga shoqëria tregtare e zotëruar nga i vëllai, pagesa ndaj të cilit është bërë me *klering*¹⁴.

Edhe në rastin konkret është vepruar në të njëjtën mënyrë. Në datën 10.04.2011 është lidhur kontrata e sipërmarrjes mes subjektit “A. M.”, person fizik dhe shoqërisë “{***}” ShPK, me objekt realizimin e punimeve ndërtimore, me një vlerë totale prej 78.775 eurosh. Ambiente të kontraktuara nga personi fizik “A. M.” dhe të shlyera nga ana e tij, nëpërmjet *kleringut*, janë blerë më pas nga subjekti i rivlerësimit me kontratën e shitjes me “{***}” ShPK, në datën 25.01.2016, po kundrejt vlerës prej 78.775 eurosh, veprim me të cilin është kthyer përfundimisht huaja prej 10.000.000 lekësh, e marrë nga vëllai, në vitet 2009/2010 dhe 2015.

¹⁴ (i) Kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.02.2012, lidhur midis porositësit “{***}” ShPK dhe sipërmarrësit “{***}” ShPK, mënyra e pagesës 100% me *klering*. (ii) Kontratën e sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.07.2012, nënshkruar mes investitor/sipërmarrës shoqëria “{***}” ShPK dhe porositësit A. M. për apartamentin me sipërfaqe 124.6 m², me vlerë 74.760 euro, që me kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.10.2015, nga shoqëria, i është shitur drejtpërdrejt blerësit E. M., dhe sipas subjektit, çmimi i është likuiduar vëllait A. M., ndër vite; (iii) Kontratën e porosisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.11.2016, mes investitorit/sipërmarrës “{***}” ShPK dhe porositësit “{***}” ShPK, me objekt porositjen e dy apartamenteve dhe dy poste parkimi, dhe mënyra e pagesës nëpërmjet punës që porositësi do të kryente. Një nga apartamentet përfitohet nga “{***}” ShPK, po me *klering*, për shkak të furnizimit të subjektit “{***}” ShPK me lëndë të parë, për mundësimin e aktivitetit të kësaj të fundit. Ndërsa apartamenti tjetër nëpërmjet deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.05.2021, të nënshkruar mes shoqërisë “{***}” ShPK, shoqërisë “{***}” ShPK dhe Ç. e V. H., është përcaktuar se të drejtat mbi këtë apartament do të kalonin me lidhjen e kontratës përfundimtare të shitjes drejtpërdrejt të këta të fundit. Në këtë deklaratë noteriale është cituar se: “Për shkak të lidhjes familjare të tyre dhe për shkak se pala Ç. H. dhe V. H. i kanë dhënë në formë huaje, në mënyrë të herëpashershme, vlera monetare më përpara në kohë, të cilat arrijnë vlerën e këtij apartamenti, prej 62.920 eurosh, palët kanë vendosur që të shlyejnë këtë detyrim ndaj njëra-tjetrës, duke i kaluar palës Ç. H. dhe V. H. të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin si pasojë e posedimit ligjor, si dhe lidhjes së kontratës së shitjes me firmën e ndërtimit”. (iv) Kontratën nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 08.02.2014, me të cilën është porositur ndërtimi i një ambienti tregtar me sipërfaqe 107 m², kundrejt çmimit 256.800 euro, likuiduar 128.400 euro nëpërmjet bankës dhe 128.400 euro nëpërmjet *kleringut*, punimeve të kryera nga “{***}” ShPK. Me deklaratën noteriale {***} rep./kol., të datës 08.05.2020, deklaruesit “{***}” ShPK, A. M. dhe P. M. kanë deklaruar, ndër të tjera, se: “[...] ‘{***}’ ShPK deklaroi se nuk ka pasur dhe nuk do të ketë në të ardhmen asnjë pretendim për vlerën e këtyre punimeve, pasi është shlyer nga znj. A. M., nga diferenca e punimeve të *kleringut* me shoqërinë ‘{***}’ ShPK [...]”. Në kontratën e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.05.2020, mes shoqërisë “{***}” ShPK dhe blerësve A. e P. M. është përcaktuar pagesa edhe sipas deklaratës noteriale. (v) Kontratën e sipërmarrjes nr. {***} kol., nr. {***} rep., datë 16.07.2014, nënshkruar mes investitorit sipërmarrës “{***}” ShPK dhe porositësit A. M., nëpërmjet së cilës sipërmarrësi merr përsipër t’i dorëzojë porositësit 3 (tre) apartamente me sipërfaqe totale 306.8 m², me vlerë totale 291.460 euro. Këto apartamente kalojnë në pronësi të A. M. në momentin që kjo shumë shlyhet me punë të verifikuar nga situacionet e firmosura. Po kështu, edhe kontratë sipërmarrjeje nr. {***}, të datës 14.07.2015, mes të njëjtave palë dhe me të njëjtat kushte, për tri poste parkimi, në vlerë totale 36.000 euro. Nga tri apartamentet: (i) me kontratën e sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 05.10.2015, ndërmjet shitësit “{***}” ShPK dhe porositësit shoqëria “{***}” ShPK, me dijeni dhe pëlqimin e sipërmarrësit investitor “{***}” ShPK, apartamenti me sipërfaqe 93.7 m² kalon në emër të shoqërisë “{***}” ShPK. (ii) Me kontratë kalim të drejtash nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.03.2017, porositësi i parë, A. M., i kalon porositësit të dytë, T. N., apartamentin me sipërfaqe 98.8 m² dhe post parkimin nr. {***}, në vlerat respektive 93.860 euro dhe 12.000 euro, pagesa do të kryhet nëpërmjet llogarive bankare, sipas parashikimit në kontratë. (iii) Me kontratë premtim shitje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.03.2017, mes shitesit A. M. dhe blerësit I. H., për apartamentin e tretë dhe garazhin nr. {***}, në vlerën totale 113.870 euro, e cila do të transferohet nëpërmjet llogarisë të noterit të llogaria bankare e A. M., në Intesa Sanpaolo Bank ShA.

18.11. Në vijim të përgjigjeve, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se kthimi i shumës 10.000.000 lekë nga vëllai ka shërbyer për formalizimin e kontratës së shitjes me shoqërinë “{***}” ShPK, në datën 25.01.2016. Formalizimi në këtë mënyrë i marrëdhënies së transferimit të pronësisë nga shoqëria ndërtuese te përfituesi, nëpërmjet shitblerjes dhe pagimit të vlerës prej 78.775 eurosh, ishte një kërkesë e shoqërisë, e cila më pas, së bashku me vëllain e subjektit, kanë deklaruar shlyerjen dhe zerimin e detyrimeve ndaj njëri-tjetrit.

18.12. Lidhur me aktivitetin tregtar të të vëllait, nga aktet administruara në dosjen gjyqësore, përkatësisht ekstraktit historik të regjistrit tregtar, rezulton të jetë regjistruar si person fizik “A. M.”, më datë 21.03.2011, me NIPT {***}, me fushë veprimtarie *shërbime punimesh si lyerje ndërtesash, punime kartonxhes* etj., me status aktiv, ndërsa më datë 23.11.2011, regjistrohet shoqëria “{***}” ShPK¹⁵, me ortak të vetëm dhe administrator A. M., me NIPT {***}, me veprimtari: *“Tregtim bojërash dhe materiale ndërtimi, shtrim pllakash, suvatime të ndryshme, lyerje objektësh, ndërtesash me material kartonxhes etj.”*.

18.13. Komisioni, në kuadër të hetimit administrativ, ka kërkuar informacion pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, lidhur me shoqërinë “{***}” ShPK dhe “A. M.”, person fizik, respektivisht për bilancet për vitet 2011 – 2021, pasqyrat financiare, vendimet e asamblesë, si dhe raport-kontrollet tatimore të kësaj periudhe. Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, me shkresën nr. {***} prot., datë 16.03.2023, për personin fizik “A. M.”, informon se nuk ka dorëzuar deklarata të ardhurash dhe rezulton me status *pasiv*, që nga data 24.12.2014 dhe detyrime të papaguara, në vlerën 20.000 lekë. Ndërsa, për shoqërinë “{***}” ShPK, Drejtoria Rajonale e Tatimeve informon se rezulton e regjistruar më datë 25.11.2011, ka deklaruar qarkullim/fitim për vitet 2012 – 2022, nuk ka shpërndarë dividendë dhe ka detyrime të papaguara në vlerën 27.500 lekë, dhe përcjell deklaratat e të ardhurave për këto vite, pasqyrat financiare për vitet 2014 – 2016, si dhe detyrimet në kohë reale.

18.14. Prej informacionit të marrë nga aktet e administruara, Komisioni ka konstatuar se: (i) në deklaratën noteriale të datës 21.01.2017, A. M. deklaroi se shumën totale prej 10.000.000 lekësh ia ka kthyer vëllait të tij, Sokol Malaj, në muajin janar të vitit 2016. (ii) Në përmbajtje të kësaj deklaratë, nuk konfirmohet se shuma është marrë si rezultat i *kleringut* të arritur me shoqërinë “{***}” ShPK. (iii) Në përmbajtjen e kontratës së shitjes, të datës 25.01.2016, nënshkruar mes subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë ndërtimore, nuk referohet asnjë e dhënë që konfirmon veprime të shlyerjes mes palëve kontraktore të sipërmarrjes, datë 10.04.2011. (iv) Lidhur me shlyerjen e pagesës, subjekti deklaroi se e ka paguar të gjithë shumën në llogarinë e noterit përmes transaksionit bankar dhe, për të provuar këtë fakt, ka depozituar dokumentin bankar që pasqyron transaksionin përkatës. (v) Subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë deklaruar në asnjë rast (deri në pyetësin nr. 4) marrëdhënien e *kleringut* të “A. M.”, si person fizik, me shoqërinë ndërtimore “{***}” ShPK, për pasurinë objekt hetimi administrativ. (vi) Me deklaratën e datës 26.01.2016, për mbyllje raporti kontraktual sipas kontratës së sipërmarrjes, datë 10.04.2011, është shprehur vullneti i palëve, përkatësisht i vëllait të subjektit, si person fizik, dhe shoqërisë ndërtimore, për të mbyllur raportin kontraktual që ata kanë pasur. Kjo marrëdhënie kontraktuale është mbyllur një ditë pas nënshkrimit të kontratës së shitjes së pasurisë mes subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë “{***}” ShPK. (vii) Dokumenti nuk konfirmon ndonjë të dhënë për kalimin e të drejtave të subjektit i rivlerësimit me lidhjen e kontratës përfundimtare të shitjes, siç është vepruar në rastet e tjera të sjella në vëmendje

¹⁵ Me vendimin e ortakut të vetëm, më datë 20.03.2016, emri i shoqërisë nga “{***}” bëhet “{***}” ShPK.

nga subjekti i rivlerësimit, apo ndonjë deklaram të mundshëm paraparak për shlyerje mes palëve të kontratës së sipërmarrjes, datë 10.04.2011.

18.15. Për sa më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kalon subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e konstatimeve se: a) ka mospërputhje në deklaramet e subjektit në deklaramen periodike vjetore 2016, se huaja është shlyer në tetor 2016, ndërsa në deklaramen noteriale, huamarrësi ka deklaruar kthimin e saj në muajin janar 2017; b) nuk provohet përfitimi i kësaj pasurie në kushtet e *kleringut*, për sa kohë pagesa e çmimit të saj është kryer me transaksion bankar në llogari të noterit; c) nuk provohet kthimi i shumës 10.000.000 lekë nga huamarrësi A. M. te subjekti i rivlerësimit; ç) nuk provohet burimi i ligjshëm i shumës 10.000.000 lekë, kthyer subjektit të rivlerësimit, në janar 2016, deklaruar nga ky i fundit se ishte marrë hua në vitet 2010 dhe 2015 dhe, për rrjedhojë, d) duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare në shumën 4.898.521 lekë (6.000.000 lekë, gjendja e *cash-it* – 10.898.521 lekë, vlera e pasurisë) të investojë në blerjen e këtyre pasurive.

18.16. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e dhëna mbi këto rezultate të hetimit administrativ, përveçse i qëndron plotësisht dhe në mënyrë ezauruese përgjigjeve të dhëna me pyetësorët, deklaron si më poshtë:

18.16.1. Mospërputhja e datave të kthimit të huas vjen për shkak të një lapsusi në deklaramen periodike vjetore 2016, e që në mbështetje të qëndrimit të Kolegjit në jurisprudencën e konsoliduar të tij,¹⁶ një deklaram i pasaktë në deklaramet e mëparshme periodike të interesave privatë, nuk mund të konsiderohet se është bërë në kundërshtim me përcaktimin e shkronjës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, për rrjedhojë, nuk është element i mjaftueshëm për t’u konsideruar si një shkak i vetëm dhe i veçuar, që prodhon situatën e deklaramit të pamjaftueshëm në kuptim të pikës 3, të nenit 61, të këtij ligji. Për më tepër, si gjatë procesit të rivlerësimit, por edhe në ILDKPKI, ky lapsus është korrigjuar nëpërmjet konsistencës së deklarameve të subjektit të rivlerësimit, në lidhje me këtë hua.

18.16.2. Duke qenë në një marrëdhënie *kleringu* me shoqërinë “{***}” ShPK, vëllai ka nënshkruar kontratë sipërmarrjeje për këtë apartament dhe njësi të tjera, dhe formalisht shlyerja e pagesave për to do të bëhej nëpërmjet kryerjes së punimeve të ndryshme për këtë shoqëri. Vlera totale e punimeve të kryera nga vëllai, nuk mbulonte 100% vlerën e të gjitha njësive të porositura, si marrëdhënie *klering*.

18.16.3. Subjekti sqaron se, që në vitin 2015, ishte dakordësuar me të vëllain për të blerë apartamentin në fjalë, duke qenë se gjatë kësaj periudhe deri në fillim të janarit 2016, vëllai A. M. ka mundur t’i shlyejë shumën e dhënë borxh, prej 10.000.000 lekësh, e cila ka shërbyer si pagesë për çmimin e përcaktuar në kontratën e shitjes, nënshkruar me shoqërinë “{***}” ShPK, në datën 25.01.2016, në vlerën 78.775 euro. Nga ky moment, kontrata e sipërmarrjes mes vëllait dhe shoqërisë ka pushuar efektet ligjore, dhe rakordimet midis palëve janë bërë duke mbajtur në konsideratë zërat e punimeve dhe kontratat për njësitë e tjera pasurore. Palët kanë deklaruar më pas shlyerjen dhe zerimin e detyrimeve ndaj njëri-tjetrit.

18.16.4. Për të provuar faktin që vëllai e dispononte shumën 10.000.000 lekë në *cash*, subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se subjektet tregtare që realizojnë kryerjen e pagesave të shërbimeve apo

¹⁶ Shih vendimet nr. 9/2020 (JR), datë 26.06.2020, nr. 16/2020 (JR), datë 13.07.2020 dhe nr. 31/2020 (JR), datë 18.11.2020, të Kolegjit.

punimeve të tyre me *klering*, gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre kanë kosto të përditshme për shpenzimet e materialeve, pagesat e punonjësve e shërbimeve dhe, për efekt të lehtësie në shlyerjen e tyre, mbajnë vazhdimisht gjendje *cash*, që administrohet nga pronarët apo administratorët e personave juridikë dhe shpesh nuk janë në llogarinë bankare të këtyre subjekteve tregtare. Ndonëse në bilancet përkatëse pranë organeve tatimore, këto subjekte tregtare mund të figurojnë me fitim të ulët në raport me shpenzimet apo edhe pa fitim, por arkëtimet e shumave përkatëse, në përfundim të marrëdhënies së *kleringut* dhe shitjes së apartamenteve të përfituara me *klering*, vërtetojnë ekzistencën e gjendjes *cash* të subjektit tregtar, jo vetëm për efekt të pasjes së shumës 10 milionë lekë në çastin e kthimit të saj, por edhe në kuadër të vazhimit të ushtrimit të aktivitetit dhe mbulimit të shpenzimeve operative të përditshme të tij.

18.16.5. Në kuadër të kontratës së sipërmarrjes mes personit fizik “A. M.” dhe shoqërisë “{***}” ShPK, apartamenti në fjalë ka kaluar në posedim të vëllait A. M., për llogari të punimeve që do të realizoheshin nga ky i fundit dhe shoqëria “{***}” ShPK. Kjo pasuri ishte lënë në ruajtje të vëllait, i cili ishte administrator dhe ortak i vetëm i shoqërisë “{***}” ShPK, në kuadër të marrëveshjes së *kleringut* dhe deri në përfundim të realizimit të punimeve të marra përsipër prej tij. Në vitin 2016, subjekti i rivlerësimit ka dashur të marrë në pronësi këtë pasuri dhe, duke qenë se i vëllai kishte një hua ndaj tij, në shumën 10.000.000 lekë, subjekti kishte menduar të shlyhej në këtë formë, pra duke përfituar këtë apartament, në vend të shumës që huamarrësi i kishte marrë hua.

18.16.6. Subjekti i rivlerësimit, për të ezauruar plotësisht barrën e provës lidhur me mundësinë e huamarrësit për kthimin e gjendjes *cash*, në muajin janar të vitit 2016, përmend edhe një herë kontratat e nënshkruara nga i vëllai me shoqëritë ndërtimore, kundrejt kryerjes së punimeve (marrëdhënieve të *kleringut*), duke vlerësuar kështu se është provuar plotësisht në kuadër të barrës së provës, se vëllai i tij kishte mundësi efektive dhe gjendje të mjaftueshme likuiditeti *cash*, në muajin janar të vitit 2016, me burim të ligjshëm, për shlyerjen e huas përkatëse ndaj subjektit të rivlerësimit. Në vijim, subjekti sqaron se rezultoni e provuar me akt zyrtar të kohës dhe jo të kryer gjatë procesit të rivlerësimit, që në muajin janar të vitit 2016 ka marrë nga vëllai huan që i kishte dhënë, në shumën 10.000.000 lekë, të cilën sapo e ka marrë, e ka depozituar në bankë (për llogari të shoqërisë “{***}” ShPK), duke kryer edhe pagesën përkatëse të pasurive që kishte blerë.

18.16.7. Subjekti i rivlerësimit ka sjellë në vëmendje qëndrimin e Kolegjit në vendimin nr. 2/2023 (JR), paragrafi 17.13, sipas së cilit, në zbatim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për personin tjetër të lidhur, analiza financiare duhet shtrirë në drejtim të verifikimit të mundësisë për të krijuar me të ardhura të ligjshme pasurinë, e cila është objekt i marrëdhënies së huas, duke përfshirë edhe shpenzimet e kryera nga personi tjetër i lidhur për të përballuar kostot e jetesës, vlerësim ky që konsiderohet i arsyeshëm dhe proporcional. Të ardhurat e vëllait janë produkt i marrëdhënies së *kleringut* gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij tregtar. Subjekti i rivlerësimit shprehet se ka arritur të provojë që i vëllai ka siguruar minimalisht nga kjo marrëdhënie *kleringu* shuma të larta monetare, duke plotësuar në këtë mënyrë detyrimin ligjor të parashikuar nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

18.16.8. Në lidhje me kthimin e huas, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se ai ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për dhënien e kësaj huaje, për rrjedhojë, nuk ka pasur për qëllim as të fshehë, as të deklarojë në mënyrë të pasaktë këtë marrëdhënie. Subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi të mos e deklarojë këtë marrëdhënie, por të deklarojë thjesht kursime *cash*, megjithatë, ai ka dashur të jetë korrekt me mënyrën e deklarimit dhe, për rrjedhojë, Komisioni nuk mund ta penalizojë për një kthim huaje, e cila në fund buron nga burime të ligjshme, si nga ana e subjektit, ashtu edhe nga ana e vëllait të tij.

18.16.9. Subjekti i rivlerësimit ka theksuar më tej se, në kuptim të nenit 3, pika 14 dhe nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, vlerësimi i rrethanave të faktit, në rastin konkret, duhet të fokusohet në analizën nëse A. M. gjendet ose jo në kushtet që e kualifikojnë atë “*person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit*”. Në zbatim të kuadrit ligjor, për efekt të procesit të rivlerësimit, subjekti detyrohet të provojë burimin e ligjshëm të pasurisë së personit të tjetër të lidhur për pasurinë e përfshirë në marrëdhënien e konfirmuar të dhurimit apo huas. Në rastin e marrëdhënies me të vëllain, subjekti nuk ndodhet në kushtet që të ketë krijuar pasuri nga huamarrje, që buron nga të ardhurat e vëllait apo dhurim prej tij, rast në të cilin do të kishte detyrimin ligjor, sipas dispozitave të mësipërme, për të provuar burimin e ligjshëm të pasurisë së personit të lidhur (vëllai), i cili huazon apo dhuron këto shuma.

18.16.10. Subjekti i rivlerësimit rithekson se shuma prej 10.000.000 lekësh është dhënë prej tij hua tek i vëllai, në dy raste, në vitet 2009/2010 dhe 2015, pasuri e cila, në respektim të detyrimit ligjor, rezulton tërësisht e justifikuar dhe e mundur të kursehej nga subjekti i rivlerësimit në vitet respektive. Rrjedhimisht, kthimi i kësaj shume në vitin 2016 nuk përfshihet më si detyrim për të provuar burimin e ligjshëm të pasurisë, po prej 10.000.000 lekësh që kthen si huamarrës, te burimi fillestar i kësaj shume, huadhënësi i tyre, i cili, në rastin konkret, ishte subjekti i rivlerësimit. Në përfundim, subjekti i ka kërkuar Komisionit të përfshijë në analizën financiare shumën prej 10.000.000 lekësh.

18.17. Gjatë seancës dëgjimore të datës 10.05.2023,¹⁷ subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se shuma prej 10.000.000 lekësh i është kthyer në *cash* nga i vëllai, dy ose tri ditë para lidhjes së kontratës së shitblerjes dhe se, për kthimin e kësaj shume, kanë shërbyer si të ardhura ato të përfituara nga shitja e pasurive që vëllai kishte si rrjedhojë e marrëdhënies së *kleringut* me shoqëritë e tjera. Gjatë seancës dëgjimore, gjithashtu, ngrihet edhe paqartësia e krijuar nga shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, pasi duket sikur kjo pasuri është paguar dy herë, nga vëllai me *klering*, dhe nga subjekti në lekë fizike, *cash*. Po kështu, ndryshe nga kontratat e tjera të depozituara nga subjekti, në kontratën e shitblerjes të nënshkruar prej tij nuk përmendet vëllai dhe as punimet e kryera nga shoqëria e tij, duke krijuar në këtë mënyrë paqartësi. Subjekti i rivlerësimit, për këtë konstatim, ka sqaruar se i vëllai e dispononte apartamentin fizikisht dhe se në atë kohë ka qëndruar me motrën, pra me shoqërinë ndërtimore i kishte zeruar detyrimet kontraktore. Ai vijon sqarimin se, faktikisht, vëllai priste t’i kalonte shumën subjektit, por u fut në një marrëdhënie tjetër të ngjashme *kleringu* dhe, në pamundësi për të kthyer shumën, u dakordësua t’i kalonte apartamentin. Pasi i vëllai bisedoi me shoqërinë për mënyrën e kalimit të pasurisë, të cilën shoqëria e kishte regjistruar tashmë në ZVRPP, kishin rënë dakord që kalimi i të drejtave të bëhej me kontratë shitblerjeje, direkt te blerësi (subjekti i rivlerësimit). Sipas subjektit, i vëllai ka rënë dakord me administratorin e shoqërisë “{***}” ShPK që, pasi të bëhej likuidimi i çmimit me bankë, për të normalizuar detyrimet mes tyre, shoqëria do t’i kthente mbrapsht atij shumën (të nesërmen nënshkruan aktin për zerimin e detyrimeve), prandaj, sipas subjektit, apartamenti nuk është paguar dy herë dhe i vëllai mori mbrapsht të njëjtën shumë nga shoqëria “{***}” ShPK.

18.18. Në vendimin objekt shqyrtimi, sa i përket kualifikimit ligjor të vëllait të subjektit të rivlerësimit si “*person tjetër i lidhur*”, sipas parashikimeve të nenit 3, pika 14 dhe nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka evidentuar rrethanat faktiko-ligjore, të cilat, në mënyrë të

¹⁷ *Shih faqen 52-53 të procesverbalit të seancës dëgjimore, pyetjet e relatores së çështjes dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit.*

përmbledhur, konsistojnë në sa vijon: (i) Burimi fundor dhe real i pasurisë nuk janë të ardhurat e realizuara nga biznesi “Klinikë dentare”, i bashkëshortes, për të cilat Komisioni nuk konstatoi ndonjë problematikë lidhur me ligjshmërinë e tyre, por ka qenë kthimi i shumës nga vëllai i subjektit, marrë si hua për ushtrimin e aktivitetit të tij. (ii) Përfshirja e drejtpërdrejtë e subjektit të rivlerësimit në krijimin e kësaj pasurie, bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 30 - 32 të ligjit nr. 84/2016, e vendosin atë përpara detyrimit ligjor për të shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të kësaj pasurie, me qëllim vlerësimin e besueshmërisë së tij në raport me procesin e rivlerësimit. (iii) Kthimi i shumës prej 10.000.000 lekësh, dy ose tri ditë përpara lidhjes së kontratës së shitjes nga subjekti, që ka shërbyer për pagesën e çmimit 78.775 euro, pagesë e cila ka qenë parakusht për zerimin dhe shlyerjen e detyrimeve ndaj shoqërisë ndërtimore, ndërkohë që pasuria i jepej vëllait për shkak të punimeve të kryera dhe posedohej e përdorej prej tij që prej vitit 2012, për sa kohë nuk u kundërshtua ndonjëherë moskryerja e punimeve sipas kontratës së sipërmarrjes, bën që pagesa edhe një herë e së njëjtës shumë nga subjekti të mbetet një situatë/rrethanë e paqartë. Në këto kushte, derdhja e shumës 78.775 euro në llogarinë e noterit, bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, i nënshtrohet provueshmërisë së burimit të krijimit të saj, huas së kthyer në vlerën 10.000.000 lekë.

18.19. Komisioni në vendim, në analizë të kontratave të depozituara nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar mundësinë e vëllait për kthimin e huas, ka konstatuar se prej tyre nuk provohet të jenë gjeneruar të ardhura në favor të vëllait ose, në disa prej tyre, ai nuk rezulton të jetë palë kontraktore, apo janë nënshkruar pas kryerjes së pagesës 78.775 euro nga subjekti i rivlerësimit, në datën 26.01.2016. Po kështu, sipas Komisionit, nga të dhënat zyrtare të administruara nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, qarkullimi dhe fitimi i aktivitetit të shoqërisë “{***}” ShPK është në vlera minimaliste, çka nuk pasqyron përfitimin e kësaj shume prej saj në qarkullimin e viteve 2013, 2014 apo 2015. Gjithashtu, fitimi i realizuar ka qenë në vlera të pakonsiderueshme, ndërkohë që në vitin 2012 figuron me humbje. Komisioni konstatoi se nuk u provua mundësia e krijimit të shumës 10.000.000 lekë për t’i shlyer huan subjektit të rivlerësimit.

18.20. Në analizë të pretendimeve të ngritura në ankim nga subjekti i rivlerësimit, në raport me konkluzionet e Komisionit, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se subjekti ka qenë kontradiktor lidhur me marrëdhënien e interesit me të vëllain, sa i përket kthimit të huas dhe përfitimit të pasurisë objekt shqyrtimi. Më konkretisht, në një vlerësim të përgjithshëm të marrëdhënies së *kleringut* dhe pozitës së vëllait lidhur me të, subjekti i rivlerësimit ka mbajtur këto qëndrime në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ: (i) *“Që në vitin 2015, isha dakordësuar me vëllain tim për të blerë apartamentin në fjalë, duke qenë se gjatë kësaj periudhe, deri në fillim të janarit 2016, vëllai [...] ka mundur të më shlyejë shumën prej 10.000.000 lekë, kam vendosur të bëj blerjen e këtij apartamenti drejtpërdrejt nga pronari, shoqëria ‘{***}’”;* (ii) *“[...] në vitin 2016, unë kam dashur ta marr në pronësi këtë apartament dhe, duke qenë se im vëlla më kishte një hua në shumën 10.000.000 lekë, unë kam menduar që të shlyhem në këtë formë, pra duke përfituar këtë apartament në vend të shumës së parave që huamarrësi me kishte marrë hua”*. Pra, në këto kushte, cenohet besueshmëria mbi kohën kur subjekti i rivlerësimit ka pasur interes për përfitimin e pasurive objekt shqyrtimi, në vitin 2015, që përputhet edhe me dhënien hua të shumës 3.500.000 lekë, apo në vitin 2016, kur pretendohet se i vëllai i ka kthyer shumën.

18.21. Subjekti i rivlerësimit mund të kishte orientuar palët në drejtim të përcaktimeve kontraktore dhe financiare, në atë mënyrë që shlyerjet e pagesave ose detyrimeve mes tyre të mos linin vend për

paqartësi, duke shmangur kështu veprime të kryera në dukje, të tilla si kthimi i huas, dy-tri ditë përpara nënshkrimit nga subjekti i rivlerësimit të kontratës së shitjes, kryerja e pagesës më datë 25.01.2016 në favor të shoqërisë “{***}” ShPK dhe, më pas, kthimi i shumës nga kjo shoqëri te z. A. M. Transaksionet e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit për qarkullimin e huas nga vëllai i subjektit të subjekti dhe më pas nga shoqëria “{***}” ShPK, përsëri te vëllai i subjektit, jo vetëm që nuk kanë logjikë financiare, por nuk gjejnë mbështetje as në dokumentacion provues, duke mbetur kështu në nivel deklarativ.

Në këto kushte, me të drejtë, Komisioni ka arsyetuar në vendim se: “[...] në një logjikë të thjeshtë interpretimi, zinxhiri i pashmangshëm i transferimit të pasurisë për llogari të subjektit të rivlerësimit, në këmbim të huas që ky i fundit i kishte dhënë të vëllait, do të ishte transferimi i pasurisë te subjekti, nën pëlqimin edhe të shoqërisë ndërtimore, pa u kryer të tjera pagesa nga subjekti i rivlerësimit, sikurse ka ndodhur. Kjo logjikë arsyetimi mbështetet edhe në vetë provat e depozituara nga subjekti, sikurse ka ndodhur në rastin e huas së marrë nga vëllai i subjektit, z. A. M., motrës së tij V. H., në shumën 62.920 euro, rast të cilin, në fakt, subjekti e trajton si identik me situatën e tij në përfitimin e pasurisë. Referuar kontratës së shitjes së pasurisë, nr. {***} rep., nr. {***}, datë 20.4.2022, midis shoqërisë “{***}” ShPK dhe bashkëshortëve H., rasti nuk përkon me situatën e subjektit të rivlerësimit, pasi në kontratë, në nenin 2 të saj, cilësohet se pasuria përfitohet në këmbim të shlyerjes së huas që shtetasi A. M. kishte ndaj motrës dhe bashkëshortit të saj, ndërsa në kontratën e shitjes së subjektit të rivlerësimit, jo vetëm një cilësim i tillë nuk ekziston, por përmbyllja e detyrimeve, sikurse u citua edhe më sipër, ka ardhur vetëm pas pagesës së shumës 78.775 euro”.

18.22. Sa i përket detyrimit për të justifikuar burimin e ligjshëm të shumës që kthen huamarrësi te burimi fillestar i saj, huadhënësi, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se konkluzioni i Komisionit në lidhje me këtë moment të hetimit dhe kthimin e huas prej 10.000.000 lekësh nga vëllai, A. M., vjen në kundërshtim me frymën e ligjit dhe vendimmarrjen e jurisprudencës së Kolegjit. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti përmend qëndrimin e Kolegjit në vendimin nr. 20 (JR), datë 03.05.2023, paragrafi 20.20, se: “[...] lidhur me huat e dhëna nga babai i subjektit në vitin 2015, z. Sh. Ll., në shumën 4.500.000 lekë dhe z. Xh. K. dhe 1.500.000 lekë, Kolegji, pasi analizoi të ardhurat e personit të lidhur në vite dhe deklaratimet e subjektit, vlerësoi se në kushtet kur nga analiza e kryer në Komision ka rezultuar mundësia financiare e personit të lidhur për dhënien e huave dy motrave të subjektit, në vlerën 45.000 euro, provueshmëria e burimeve të ligjshme për kthimin e tyre është një barrë që tejkalon parashikimin e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, në kushtet kur ky kthim nuk shoqërohet me përfitimin e ndonjë interesi apo me dyshimet për ndonjë situatë fshehjeje pasurie. [...]”. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se situata faktiko-ligjore në çështjen objekt shqyrtimi nuk gjen mbështetje në qëndrimin e mbajtur nga Kolegji në këtë rast, të sjellë në vëmendje nga subjekti i rivlerësimit. Në rastin konkret, mungesa e dokumentacionit provues për kthimin e shumës, pretendimi i transaksioneve në dukje, pa përfaqësuar vullnetin e vërtetë të palëve, qëndrimet e paqarta të subjektit të rivlerësimit, përmbajtja e kontratës së shitjes, e datës 25.01.2016, si dhe kryerja nga subjekti e pagesës së çmimit 78.775 euro, legjitimojnë kryerjen e verifikimit të burimit të ligjshëm të kësaj shume në drejtim të provueshmërisë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë çështje.

18.23. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, që konkluzioni i Komisionit, se nga kontratat dhe praktikat e administruara nuk provohet të jenë gjeneruar të ardhura në favor të vëllait, përbën interpretim të kundërt dhe të gabuar të akteve të analizuara, referuar marrëdhënieve kontraktore të krijuara dhe të ekzekutuara për mbi dhjetë ambiente, apartamente/njësi/garazhe, trupi gjykues i

Kolegjit konstaton se subjekti i rivlerësimit është munduar që, nëpërmjet kontratave të depozituara, të provojë mënyrën se si operon tregu i ndërtimeve, si dhe natyrën e marrëdhënieve të *kleringut* mes shoqërive tregtare në këtë kuadër. Pavarësisht se vëllai i subjektit mund të ketë përfituar të ardhura në kuadër të aktivitetit të ushtruar prej tij, subjekti i rivlerësimit, ashtu siç arsyeton edhe Komisioni në vendim, nuk bëri përpjekje gjatë këtij procesi për të vërtetuar minimalisht të ardhurat e përfituara nga një kontratë shitjeje apo kthimin e shumës nga shoqëria “{***}” ShPK, në kushtet kur veprimet janë kryer në vite në të cilat ekonomia ka qenë e formalizuar dhe veprimet nga shoqëritë ndërtimore përmbylleshin nëpërmjet sistemit bankar apo noterit publik.

18.24. Për pasuritë “apartament banimi me sipërfaqe 96 m² + 51.7 m²”, në vlerën 68.060 euro, si dhe “garazh”, me sipërfaqe 33.2 m², në vlerën 10.715 euro, me adresë: rruga “{***}”, Selitë, Tiranë, trupi gjykues i Kolegjit e gjen të bazuar konkluzionin e Komisionit, se subjekti i rivlerësimit nuk është i besueshëm në shpjegimet e deklaratimet e tij lidhur me mënyrën se si është krijuar kjo pasuri, në vijim të analizës së disa aspekteve si:

Së pari, kontrata e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.01.2016, e nënshkruar mes shoqërisë “{***}” ShPK dhe subjektit të rivlerësimit ka fuqinë e ligjit dhe, në asnjë formë e asnjë moment kohor, palët nuk kanë përcaktuar apo evidentuar se pjesë e marrëdhënies mes tyre ishte edhe marrëdhënia e sipërmarrjes së vëllait të subjektit me shitësin/shoqërinë ndërtimore. Përkundrazi, edhe në “Deklaratën për mbyllje raporti kontraktual, sipas kontratës së sipërmarrjes datë 10.04.2011”, e nënshkruar më datë 26.01.2016, mes ndërtuesit me vëllain e subjektit të rivlerësimit, logjikisht, shumë afër në kohë me momentin kur u materializua tjetërsimi i pasurisë, sipas versionit të pretenduar nga subjekti (si akt këmbimi i marrëdhënies dhe detyrimeve ndaj të vëllait nga ndërtuesi), palët nuk referojnë në asnjë moment të kenë pasur një dakordësi, që përfshin në panoramë subjektin e rivlerësimit.

Së dyti, subjekti i rivlerësimit ka kryer vetë personalisht të gjitha veprimet financiare që lidhen me përfitimin e kësaj pasurie dhe, në ato veprime, nuk rezulton referencë e detyrimit që shoqëria ndërtuese kishte ndaj vëllait të tij.

Së treti, për herë të parë, marrëdhënia/detyrimi i ndërtuesit ndaj vëllait të subjektit të rivlerësimit është ngritur si argument me përgjigjet e pyetësorit nr. 4, në muajin mars të vitit 2023. Në asnjë prej akteve të periudhës nga janari 2016 e deri në mars 2023, nuk ka gjetur referencë fakti që apartamenti ishte objekt i një marrëdhënieje të mëparshme kontraktuale të vëllait të subjektit.

Së katërti, subjekti i rivlerësimit rezultoi kontradiktor dhe jo i besueshëm sa i përket shpjegimeve të dhëna për mënyrën e krijimit të këtyre pasurive gjatë procesit të rivlerësimit në Komision. Veprimet e mësipërme prekin vërtetësinë e transaksionit e, për pasojë, besueshmërinë e deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me burimin e krijimit të këtyre pasurive gjatë këtij procesi.

18.25. Trupi gjykues i Kolegjit, në vijim të vlerësimit të besueshmërisë së deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit, nuk u bind lidhur me kthimin e huas nga vëllai i tij, pasi edhe në konsideratë të pretendimeve të subjektit, se shuma 10.000.000 lekë i është kthyer në janar të vitit 2016, sërish nuk u arrit të provohej mundësia financiare e vëllait të subjektit për kthimin e kësaj shume nga të ardhura me burime të ligjshme.

18.26. Trupi gjykues i Kolegjit, për arsyet si më sipër, nuk e vlerëson kthimin e huas prej 10.000.000 lekësh si burim të ligjshëm dhe, për pasojë, nuk e përfshiu në analizën financiare të kontrolluar në Kolegj, duke çuar kështu subjektin e rivlerësimit në pamjaftueshmëri burimesh të ligjshme financiare

për krijimin e pasurive të ndodhura në rrugën “{***}”, Selitë, Tiranë, me pasojë edhe në krijimin e pasurive të tjera në vitin 2016, si: (i) apartament me sipërfaqe 176 m² dhe dy garazhe me sipërfaqe 25 m², ndodhur në rrugën “{***}”, pallati “{***}”, Tiranë, në vlerën 15.990.500 lekë; (ii) shlyerjen e këstit të fundit të apartamentit 73 m², ndodhur në “{***}”, Tiranë, në shumën 10.150 euro, si dhe mbulimin e shpenzimeve të kryera në këtë vit. Subjekti i rivlerësimit rezultoi me mungesë të burimeve financiare të ligjshme në vlerën (-) 4.067.938 lekë, për krijimin e pasurive më datë 25.01.2016, dhe (-) 9.519.824 lekë për vitin 2016, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 e, për rrjedhojë, në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm të pasurisë, sipas nenit 61, pika 3 e këtij ligji.

*B/3. Në lidhje me aksionet e subjektit të rivlerësimit në shoqërinë “{***}” ShPK, pozitën dhe rolin e tij, në raport me ushtrimin e funksionit të magjistratit/prokurorit*

19. Komisioni, lidhur me këtë çështje, ka konkluduar se: *Subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut, pasi ai është ekspozuar në një marrëdhënie ku përfitimet materiale të tij, të cilat buronin nga veprimtaria tregtare, janë tërësisht të varura në vullnetin dhe dëshirën e shoqërisë, lidhur me ushtrimin e aktivitetit tregtar. Pra, ekspozimi i subjektit të rivlerësimit në një lloj marrëdhënieje të tillë me shoqërinë tregtare e ka bërë atë një subjekt që mund të ndikohet në ushtrimin e detyrës së tij në mënyrë të pavarur, për shkak të nevojës së tij për garantimin e përfitimeve materiale nga kjo veprimtari. Në këto rrethana, subjekti i rivlerësimit e ka ekspozuar hapur veten ndaj rrezikut që krijon premisë për rënie në ndikueshmëri lidhur me përmbushjen e detyrave të tij publike. Trupi gjykues çmon se pjesëmarrja e subjektit në këtë veprimtari dhe mbajtja e aksioneve aktive, edhe pas ndalimeve ligjore sipas ligjit nr. 96/2016, ka prodhuar një mospërputhje thelbësore me funksionin e prokurorit dhe detyrimet në lidhje me etikën. Në këtë kuptim, bazuar në nenin 61/5 të ligjit nr. 84/2016, rrethanat e kësaj çështjeje në raport me sjelljen e subjektit kundrejt detyrimeve ligjore konsiderohen nga trupi gjykues si fakte të çështjes, që janë të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk mund të gëzojë besimin e publikut për të qëndruar në detyrë.*
20. Subjekti i rivlerësimit në ankim ka pretenduar se: (i) Konkluzioni i Komisionit është rrjedhojë e interpretimit dhe zbatimit të gabuar të ligjit. (ii) Gjetjet dhe konkluzionet e Komisionit mbi zotërimin e kuotave në shoqërinë tregtare “{***}” ShPK dhe arsyetimi se është cenuar besimi i publikut nga subjekti i rivlerësimit, për shkak të ekspozimit të tij në një marrëdhënie ku përfitimet e tij materiale burojnë nga shoqëria tregtare, dhe “janë të varura në vullnetin dhe dëshirën e shoqërisë”, “mundësinë e ndikimit të ushtrimit e detyrës në mënyrë të pavarur” apo “ekspozimi ndaj rrezikut që krijon premisë për rënie në ndikueshmëri”, janë vetëm arsyetime të përgjithshme dhe teorike, për të mbështetur një vendimmarrje të Komisionit, jo të bazuar në ligj. Nuk u evidentua në asnjë rast nëse prokurori subjekt rivlerësimi është ndikuar në ushtrimin e detyrës së tij për shkak të zotërimit të këtyre kuotave. (iii) Subjekti i rivlerësimit -- nuk ka vepruar në asnjë rast në kushtet e konfliktit të interesit në ushtrimin e detyrës së tij; -- shoqëria “{***}” ShPK nuk ka influencuar në asnjë rast apo rrethanë në ushtrimin e detyrës si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë; -- të ardhurat e përfituara nga subjekti i rivlerësimit nga fitimet e shoqërisë tregtare, dukshëm, kanë ndikuar në rritjen e pavarësisë së tij ekonomike dhe, rrjedhimisht, edhe profesionale. (iv) Konstatimet e Komisionit nuk janë fakte që tregojnë në mënyrë përcaktuese se subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kundërshtim me ligjin, por janë çështje që kanë nevojë për një analizë të detajuar ligjore, identifikimin e qëllimit primar të ligjvënësit kur i ka parashikuar ato, si dhe rëndësisë dhe proporcionalitetit të pasojave dhe efekteve që kanë sjellë këto veprime, të cilat, në asnjë rast, nuk

mund të kenë efekt shkarkimin nga detyra, por vetëm këshillimor, në kushtet kur subjekti ka marrë masa dhe ka vepruar në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi për të mënjeluar papajtueshmëritë e përcaktuara në ligj.

21. Lidhur me këtë çështje, nga analizimi i akteve të administruara në dosjen gjyqësore të Komisionit, trupi gjykues konstaton si vijon:

21.1. Në deklaratën periodike vjetore 2014, në rubrikën e pasurive, subjekti i rivlerësimit deklaroi: *“Shoqëria “{***}” ShPK, me NIPT {***}, regjistruar në datën 20.02.2014, me objekt “transportin e hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tyre”. Pjesa takuese: 100%”*. Në deklaratën periodike vjetore 2015, subjekti i rivlerësimit deklaroi shitjen e 50% të aksioneve të kësaj shoqërie, në vlerën 3.000.000 lekë, si dhe të ardhura nga shpërndarja e dividendit në vlerën 10.200.000 lekë. Këtë lloj të ardhure nga dividendi, subjekti i rivlerësimit e deklaroi edhe në deklaratën periodike vjetore 2016, në vlerën 8.000.000 lekë.

21.2. Qendra Kombëtare e Biznesit (në vijim “QKB”), me shkresën nr. {***} prot., datë 27.05.2021, informon se z. Sokol Malaj figuron ortak me 50% të kuotave (zotërues pasiv) në shoqërinë “{***}” ShPK, me NIPT {***}. Referuar ekstraktit historik të regjistrimit tregtar, kjo shoqëri është themeluar në datën 10.02.2014 dhe regjistruar në datën 20.02.2014 në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (sot, Qendra Kombëtare e Biznesit), me seli në qytetin e Vlorës, rruga “{***}”, me objekt aktiviteti “transportin brenda dhe jashtë vendit, tregtimin me shumicë dhe pakicë, importimin, eksportimin e naftës dhe nënprodukteve të saj etj.”. Kapitali themeltar i kësaj shoqërie tregtare ka qenë 100.000 lekë, me ortak të vetëm z. Sokol Malaj dhe përfaqësues ligjor, administrator, fillimisht, z. A. H. dhe, më pas, z. G. L. Në datën 23.03.2015 është depozituar kontrata noteriale e shitjes së 50% të kuotave të shoqërisë tek ortaku, z. K. K.

21.3. Lidhur me vlerën e investuar në këtë shoqëri, ka rezultuar se, me kontratën për kredi afatmesme nr. {***}/01.08.2014, nënshkruar më datë 07.08.2014, mes kredidhënësit Tirana Bank ShA, Dega Vlorë, dhe kredimarrësit, shoqërisë “{***}” ShPK, me përfaqësues dhe dorëzues Sokol Malaj, është financuar kredi me një kohëzgjatje 2 (dy) vjet, në vlerën 130.733 USD, me qëllim blerjen e aseteve fikse (automjete). Ndërsa, me kontratën për dhënie kredie bankare në një llogari rrjedhëse (overdraft), nr. {***}/09.08.2014, mes të njëjtave palë kontraktore, është financuar kredi - overdrafti për shumën 37.267 USD, për t’u përdorur për kapital qarkullues. Subjekti i rivlerësimit, si burim për investimin e kryer në shoqëri, ka paraqitur me deklaratën e pasurisë *vetting* edhe kontratën e huas së datës 05.09.2014, me afat 2-vjeçar, të nënshkruar mes z. D. K., i cilësuar si dhënësi i ndihmës financiare, dhe shoqërisë “{***}” ShPK, përfaqësuar nga administratori G. L., në cilësinë e marrësit të ndihmës financiare, të shumës 73.000 euro, për realizimin nga shoqëria të aktivitetit tregtar në fushën e hidrokarbureve. Gjatë kontrollit në ILDKPKI, më datë 09.02.2016, subjekti i rivlerësimit ka shtuar se ka pasur *një kontratë transporti me vlerë mbi 2.000.000 \$, me shoqërinë “{***}” dhe “{***}”, ka realizuar fitim, me të cilin është kryer investim për blerjen e mjeteve të tjera shtesë.*

21.4. Gjatë hetimit administrativ, në pyetësorin nr. 2, Komisioni ka konstatuar se pozita e subjektit të rivlerësimit në ushtrimin e këtij aktiviteti bie ndesh me nenin 143 të Kushtetutës dhe i kërkon atij të përshkruajë rolin dhe pjesëmarrjen në aktivitetin e shoqërisë, që nga krijimi i saj e në vazhdim. Në përgjigjet e tij, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se:

21.4.1. Në momentin e themelimit dhe regjistrimit të kësaj shoqërie tregtare, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në fuqi, në nenin 143 të saj, parashikonte se *“Qenia gjyqtar nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër shtetërore, politike ose private”*, ndërsa në nenin 148, pika 3, përcaktonte se në ushtrimin e kompetencave të tyre, prokurorët u nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve. Në këtë mënyrë, ndalimet dhe papajtueshmëritë me detyrën e prokurorit, ligjvënësi i ka trajtuar me ligjin organik të kohës, ligjin nr. 8737, datë 12.02.2001, *“Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar (në vijim *“ligji nr. 8737/2001”*), i cili, në nenin 39, pika 4, përcaktonte se: *“Prokurorit i ndalohet të marrë pjesë në organet drejtuese të shoqërive tregtare”*. Neni 95 e vijues i ligjit nr. 9901/2008, *“Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”* (në vijim *“ligji nr. 9901/2008”*), përcakton si organ drejtues të shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar administratorët e saj, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit shprehet se është kujdesur të veprojë në përputhje me ndalimin e nenit 39, pika 4 e ligjit nr. 8737/2001, duke mos qenë në asnjë rast pjesë e organeve drejtuese të kësaj shoqërie tregtare, duke mos marrë pjesë, as ndikuar në veprimtarinë e përditshme të saj.

21.4.2. Në ndryshimet e Kushtetutës me ligjin nr. 76/2016 u miratua nga ligjvënësi neni 149/ç, i cili, për herë të parë, parashikon papajtueshmërinë e prokurorit me asnjë veprimtari profesionale që ushtrohet kundrejt pagesës, çka sipas subjektit të rivlerësimit, nuk është rasti i tij. Ndërkohë që ligji organik nr. 96/2016, *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar (në vijim *“ligji nr. 96/2016”*), në nenin 7, *“Kufizimet për shkak të funksionit”*, në pikën 4 të tij¹⁸, parashikon ndalimet ligjore të magjistratit, subjekti i rivlerësimit i ka zbatuar me korrektësi këto përcaktime ligjore, duke e vendosur cilësinë si ortak pranë shoqërisë *“{***}”* ShPK në kushtet e shkronjës *“b”* të kësaj dispozite, nëpërmjet lidhjes me z. E. Xh., të marrëveshjes për zotërimin pasiv të kuotave dhe depozitimim e saj rregullisht pranë QKB-së. Gjatë gjithë kësaj periudhe, subjekti sqaron se është kujdesur të mos ketë asnjë ndikim mbi shoqërinë tregtare.

21.4.3. Për ekzistencën e kësaj shoqërie tregtare, cilësinë si ortak dhe pjesëmarrjen në të, subjekti i rivlerësimit sqaron se e ka deklaruar në mënyrë korrekte dhe të përvitshme pranë ILDKPKI-së, autoriteti shtetëror i përcaktuar me ligj për të konstatuar dhe verifikuar kushtet e konfliktit të interesit për zyrtarët publikë. Ky institucion i ka vlerësuar në çdo rast të sakta deklaratimet e subjektit dhe jo në kushtet e konfliktit të interesit, pasi, në të kundërt, ka pasur detyrimin ligjor për të ndërmarrë procedim administrativ ndaj tij, ndërkohë që asnjë fakt i tillë nuk është konstatuar apo pretenduar nga ILDKPKI-ja.

21.5. Komisioni¹⁹ ka kërkuar opinion ligjor nga ILDKPKI-ja lidhur me pozitën dhe veprimtarinë e subjektit të rivlerësimit në shoqërinë *“{***}”* ShPK, në raport me ushtrimin e funksionit të prokurorit, qëllimin dhe zbatimin e ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, *“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”*, i ndryshuar (në vijim *“ligji nr. 9367/2005”*) dhe në raport me nenin 7, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, dispozitë kjo që, në disa raste, parashikon ndalesat në përputhje

¹⁸ Neni 7, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, parashikon: *“4. Magjistratit i ndalohet: a) të administrojë, të drejtojë ose të ushtrojë ndikim në shoqëritë tregtare ose fitimprurëse, personalisht ose nëpërmjet përfaqësimit; b) të zotërojë në mënyrë aktive aksione ose pjesë të kapitalit të një shoqërie tregtare, në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit; c) të zotërojë në mënyrë pasive aksione ose pjesë të kapitalit të një shoqërie tregtare, nëse shoqëria ka fitime ose të mira nga kontratat publike, në përputhje me legjislacionin për parandalimin e konfliktit të interesit në fuqi; ç) të zotërojë në mënyrë pasive aksione ose pjesë të kapitalit të një shoqërie tregtare, në të cilën veprimtaria e magjistratit është e ndaluar, për shkak se mund të ndikojë në pavarësinë e magjistratit, krijon konflikt interesi ose krijon përshtypjen që magjistrati është i njëanshëm ose i ndikuar”*.

¹⁹ Me shkresën nr. *{***}* prot., datë 26.01.2023.

me legjislacionin për parandalimin e konfliktit të interesit, ligj i cili ka funksionuar që prej vitit 2005 e në vijim.

21.6. ILDKPKI-ja, në përgjigjen e saj²⁰, fillimisht analizon qëllimin, objektin dhe dispozitat e ligjit nr. 9367/2005, përkatësisht nenet 3, 4, 5, pika 4, nenet 7, 21, pika 1, nenet 26 dhe 37, përmend faktin që Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë ka miratuar kërkesën e z. Sokol Malaj për transferimin e zotërimit aktiv të kuotave të tij te personi i besuar, z. E. Xh., duke u bërë zotërues pasiv i këtyre kuotave, si dhe korrespondencën me Agjencinë e Prokurimit Publik,²¹ e cila informon se shoqëria “{***}” ShPK, me NIPT {***}, nuk është regjistruar në Sistemin e Prokurimit Publik, si dhe nuk është shpallur fituese në procedura prokurimi elektronik për periudhën 01.01.2017 – 31.12.2020. Në vijim, sipas ILDKPKI-së, duhet të mbahet në konsideratë fakti se kufizimet e interesave privatë për parandalimin e rasteve të veçanta të konfliktit të vazhdueshëm të interesave nuk shterohen vetëm nga ligji nr. 9367/2005, i ndryshuar, por mund të jenë të parashikuara në ligje të posaçme për funksione të veçanta, parim i parashikuar në nenin 26 të këtij ligji, sipas së cilit, nëse ka dy kufizime të ndryshme për të njëjtin interes, do të zbatohet kufizimi më i rreptë, ai kufizim që zvogëlon më shumë rrezikun e shfaqjes së konfliktit të interesit.

Kushtetuta, në nenin 149/ç, parashikon se funksioni i prokurorit *nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër shtetërore ose politike, si dhe me veprimtari profesionale që ushtrohet kundrejt pagesës, me përjashtim të aktivitetit mësimdhënës, akademik ose shkencor*. Më tej, ligji nr. 96/2016, në nenin 6, pika 1, dhe nenin 7, pika 4, parashikon papajtueshmëritë dhe kufizimet e magjistratit për shkak të funksionit. Në zbatim të nenit 37, pika 1 e ligjit nr. 9367/2005, zyrtari duhet të trajtojë dhe të zgjidhë situatat e konfliktit të interesit, duke nënvizuar shkronjën “a” të kësaj dispozite “*duke transferuar a tjetërsuar interesat privatë*”, duke parashikuar më tej zgjidhjen e rasteve të veçanta të konfliktit të vazhdueshëm të interesave, sipas nenit 38, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 9367/2005, “*Të transferojë të drejtat e zotërimit aktiv të aksioneve apo të pjesëve në kapital që zotëron te një person tjetër, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 3 të këtij ligji [...]*”.

Në përfundim të shkresës, në zbatim të dispozitave ligjore të sipërcituara, bazuar në analizën dhe trajtimin e të dhënave të administruara, ILDKPKI konstaton se z. Sokol Malaj ka marrë masa për të zgjidhur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik në një nga mënyrat e parashikuara nga kuadri ligjor në fuqi, se nuk është ndodhur në kufizimet e parashikuara nga neni 21, pika 1 e ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar, duke mos përfituar nga fondet publike për procedurat e regjistruara pranë Agjencisë së Prokurimit Publik, si dhe objekti i veprimtarisë së shoqërisë tregtare është në një fushë, e cila nuk ndërlihet apo pritet me funksionin e magjistratit.

21.7. Në kuadër të hetimit administrativ, Komisioni administron shkresën nr. {***} prot., datë 16.03.2023, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë, e cila vë në dispozicion, ndër të tjera, bilancet e shoqërisë “{***}” ShPK, me NIPT {***}, për vitet 2014 – 2021, me pasqyrat financiare dhe shpjegimet për secilin vit, vendimet e asamblesë të depozituara për këto vite, si dhe raportin për kontrollin tatimor të ushtruar brenda kësaj periudhe. Referuar vendimeve të Asamblesë së Ortakëve²², të konstatuara edhe në ekstraktin historik të shoqërisë, në faqen zyrtare të QKB-së, rezulton se subjekti i rivlerësimit:

²⁰ Me shkresën nr. {***} prot., datë 07.02.2023.

²¹ Me shkresën nr. {***} prot., datë 26.05.2021.

²² Referuar nenit 9/2/b të Aktit të Themelimit të Shoqërisë dhe Statutit, të drejtat e ortakëve të Asamblesë së Përgjithshme.

21.7.1. Në cilësinë e ortakut të vetëm, ka marrë këto vendime: (i) vendimi i datës 22.04.2014, për shkarkimin e administratorit, z. A. H. dhe emërimin e administratorit të ri, z. G. L.; (ii) kërkesë, datë 25.09.2014, për të hapur adresë sekondare në Fier; (iii) vendimin nr. {***}, datë 13.11.2014, për të zgjeruar aktivitetin me veprimtari transporti ndërkombëtar mallrash për të tretë dhe me qira; (iv) vendimin nr. {***}, datë 26.02.2015, për të hapur adresë sekondare, mjet transporti; (v) vendimin e datës 17.03.2015, për miratimin e transferimit të 50% të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë “{***}” ShPK.

21.7.2. Në cilësinë e ortakut me 50% të kuotave të kapitalit në pronësi, ka nënshkruar së bashku me ortakun tjetër, z. K. K.: (i) vendimin nr. {***}, datë 18.06.2015, për miratimin e pasqyrave financiare për vitin 2014 dhe të shpërndarjes së fitimit të realizuar; (ii) vendimin nr. {***}, datë 20.06.2016, për miratimin e pasqyrave financiare për vitin 2015; (iii) vendimin nr. {***}, datë 25.07.2017, për miratimin e pasqyrave financiare për vitin 2016.

21.7.3. Referuar vendimit të datës 26.03.2018, Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë vendosi: (1) miratimin e kërkesës së ortakut, z. Sokol Malaj, për transferimin e zotërimit aktiv të kuotave të kapitalit të shoqërisë “{***}” ShPK në pronësi të tij, te personi i besuar, z. E. Xh., sipas marrëveshjes mes tyre; (2) me nënshkrimin e marrëveshjes për zotërimin pasiv të 50% të kuotave të kapitalit të shoqërisë “{***}” ShPK nga ortaku Sokol Malaj te personi i besuar E. Xh., z. Sokol Malaj bëhet zotërues pasiv i tyre; (3) shoqëria nuk do të kryejë asnjë veprimtari fitimprurëse që buron nga kontratat publike, me qëllim zbatimin me korrektësi të pikës 4, të nenit 7, të ligjit nr. 96/2016; (4) administratorit të shoqërisë nuk i lejohet dhe nuk ka kompetenca për të nënshkruar kontrata apo çdo lloj marrëveshjeje, e cila mund të ketë lidhje me veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit, e pushtetit vendor apo kontratat publike, dhe shoqërisë i ndalohet të përfitojë këto lloj të ardhurash.

21.7.4. Pas vendimit të mësipërm për transferimin e zotërimit aktiv të kuotave, rezulton që personi i besuar të ketë nënshkruar vetëm vendimin nr. {***}, datë 30.06.2018, të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë, për miratimin e pasqyrave financiare për vitin 2017. Vendimet e tjera të Asamblesë së Ortakëve të viteve 2019, 2020 dhe 2021 rezultojnë të jenë nënshkruar vetëm nga ortaku K. K. Pavarësisht caktimit të personit të besuar, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar vendimin e datës 10.02.2019, të Asamblesë së Ortakëve, me të cilin është vendosur që fitimi i pashpërndarë i viteve 2015, 2016 dhe 2017, në shumën 39.600.000 lekë, të shpërndahet në formë dividendi për ortakët e shoqërisë.

21.7.5. Me vendimin e datës 26.08.2021, Asambleja e Ortakëve (z. Sokol Malaj dhe z. K. K.), vendosi miratimin e kërkesës së ortakut, z. Sokol Malaj, për heqjen e zotërimit aktiv të kuotave të zotëruara prej tij në kapitalin e shoqërisë “{***}” ShPK, nga personi i besuar z. E. Xh. dhe transferimin e tyre te personi i besuar, z. S. M., sipas marrëveshjes së dakordësisë mes tyre, duke rikonfirmuar përcaktimet në pikat 2 - 4 të vendimit të datës 26.03.2018. Në vijim, vendimet rezultojnë të jenë nënshkruar nga personi i besuar, z. S. M.

21.8. Bazuar në nenet 4 dhe 12 të “Rregullave mbi Etikën dhe Sjelljen e Prokurorëve”, miratuar me urdhrin nr. 141, datë 19.06.2014, të Prokurorit të Përgjithshëm të asaj kohe, Komisioni kërkoi informacion nga Prokuroria e Përgjithshme dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nëse subjekti i rivlerësimit kishte njoftuar mbi angazhimin në shoqërinë “{***}” ShPK dhe

nëse ishte marrë miratimi përkatës. Të dyja prokuroritë²³ informuan se nuk rezultonte i regjistruar ndonjë njoftim/shkresë e tillë nga subjekti i rivlerësimit.

21.9. Komisioni, duke u bazuar në kuadrin ligjor,²⁴ përgjigjet e subjektit të rivlerësimit për pyetësoin nr. 2, të datës 05.01.2023, dokumentacionin e administruar, statutin e shoqërisë “{***}” ShPK, si dhe në kushtet kur subjekti ka përfituar të ardhura nga dividendi për vitet 2015 dhe 2016 dhe, në deklaratën e pasurisë *vetting*, ka deklaruar si burim krijimi të apartamentit dhe dy garazheve, të blera më datë 07.10.2016, edhe këto të ardhura, i kalon subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e këtyre konstatimeve:

i. Pjesëmarrja në organe drejtuese të shoqërisë, për sa kohë u provua se, si ortak i Asamblesë, ai ka kryer veprime (konkretisht ka ndërmarrë vendime) për llogari të shoqërisë, duket se bie ndesh me përcaktimet e nenit 39, pika 4 e ligjit nr. 8737/2001, i ndryshuar, sipas së cilit: *“Prokurorit i ndalohej të marrë pjesë në organet drejtuese të shoqërive tregtare”*.

ii. Krijimi/fitimi i të ardhurave nga shpërndarja e dividendit *duket se përfshihet në interesat privatë të zyrtarit* dhe, për rrjedhojë, duket se ka ekzistuar gjendja e konfliktit të interesit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të zyrtarit, të subjektit të rivlerësimit në këtë rast.

iii. Pavarësisht se veprimi i ndërmarrë/nënshkrimi i marrëveshjes është në përputhje me ndalesën e parashikuar në nenin 7, pika 4, shkronja “b” e ligjit nr. 96/2016 dhe me nenin 3, pika 6 e ligjit nr. 9367/2005, duket se subjekti nuk e ka caktuar personin e besuar njëkohësisht me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 96/2016, por e ka ndërmarrë këtë veprim më datë 26.03.2018, pra rreth 18 muaj më pas.

iv. Duket se subjekti i rivlerësimit, me vendimmarrjen e tij, të datës 25.07.2017, për miratimin e pasqyrave financiare të shoqërisë për vitin 2016, ka vepruar në kundërshtim me ndalesën e parashikuar në nenin 7/4/b të ligjit nr. 96/2016. Po në kundërshtim me këtë dispozitë ka vepruar dhe me vendimmarrjen e datës 10.02.2019, për shpërndarjen e fitimit të akumuluar për vitet 2015, 2016 dhe 2017, në formë dividendi për ortakët, për shkak se ai kishte kaluar në zotërim pasiv të kapitalit që me marrëveshjen e datës 26.03.2018, e cila ka parashikuar që veprimet e tjera, me përjashtim të së drejtës së ortakut pasiv për përfitimin e fryteve civile të pronësisë, duhet të ndërmerreshin nga i besuari.

v. Duket se subjekti është në shkelje/kundërshtim me ligjin nr. 8737/2001, i ndryshuar, dhe urdhrin nr. 141, *“Për miratimin e rregullave etike dhe të sjelljes së prokurorëve”*, prej vitit 2014 deri në vitin 2016, lidhur me ushtrimin e këtij aktiviteti, arsye që pengon pjesëmarrjen e prokurorëve në organet drejtuese të kompanive private.

vi. Duket se subjekti, nga viti 2016 deri në vitin 2018, ka vepruar në shkelje/kundërshtim me ligjin

²³ Me shkresat respektive, nr. {***} prot., datë 15.02.2023, dhe nr. {***} prot., datë 16.02.2023.

²⁴ Ligji nr. 8417, datë 21.10.1998, *“Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar, neni 143 dhe 148; ligji nr. 8737, datë 12.02.2001, *“Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar (neni 39/4); ligji nr. 97/2016, *“Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar; ligji nr. 9367, datë 07.04.2005, *“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”*, i ndryshuar (nenet 3.1, 3.5 dhe 5); ligji nr. 96/2016, *“Për statusin e magistratit në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, neni 7; ligji nr. 9901, datë 14.04.2008, *“Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”* i ndryshuar, neni 68 e vijues; Komentari mbi Parimet e Banglores të Sjelljes Gjyqësore, 2007, paragrafi 169, *“Aktivitetet financiare”*; urdhri i Prokurorit të Përgjithshëm nr. 141, datë 19.06.2014, *“Për miratimin e rregullave etike dhe të sjelljes së prokurorëve”* neni 4, shkronja “ç”; vendimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 32, datë 24.02.2022, *“Për miratimin e standardeve etike dhe rregullave të sjelljes së prokurorëve”*, neni 12.

nr. 96/2016, i cili ndalon magjistratët të mbajnë aktivisht aksione në kompani private, pasi akti/marrëveshja me personin e besuar u nënshkrua në vitin 2018.

vii. Në vijim dhe deri aktualisht, duket se subjekti i rivlerësimit, në ushtrimin e këtij aktiviteti, vijon të jetë në shkëlqje, në kundërshtim me nenin 149/ç të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe nenin 7/4/ ç të ligjit nr. 96/2016.

viii. Në tërësi, duket se subjekti i rivlerësimit, me veprimet dhe mosveprimet e tij, ka vepruar në papajtueshmëri me detyrën e prokurorit, bazuar në Kushtetutë, në nenin 39/4 të ligjit nr. 8737/2001, si dhe ligjin nr. 9367/2005, i ndryshuar.

21.10. Në prapësimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se këto konstatime nuk provojnë që ai ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit për të ndikuar negativisht në vlerësimin etik, me efekt shkarkimin nga detyra. Komisioni, sipas tij, ka bërë një interpretim shumë të ngushtë të kuadrit ligjor,²⁵ interpretim që ka sjellë cenimin në mënyrë të paarsyeshme, joproporcionale dhe të pambështetur në ligj, të të drejtave të tjera themelore kushtetuese, që mbrohen dhe garantohen nga rendi ligjor në fuqi, sikurse është e drejta e pronës private dhe e drejta e gëzimit të saj pa kufizime, për sa kohë nuk cenon interesin publik. Subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të shtjelluara gjerësisht lidhur me konstatimet e Komisionit, duke i bërë një interpretim ndryshe dispozitave kushtetuese dhe ligjore. Në prapësimet mbi rezultatet e hetimit, ndër të tjera, në mënyrë të përmbledhur, subjekti ka sqaruar se:

21.10.1. Sipas subjektit të rivlerësimit, qëllimi i ligjvënësit, kur ka parashikuar ndalime ligjore për subjektet që ushtrojnë detyrën e magjistratit për të mos pasur një veprimtari aktive në fushën tregtare, ka qenë që të japë garanci ligjore për vendimmarrje të paanshme, transparente, në interesin më të mirë të mundshëm të publikut e të besimit të tij ndaj institucioneve publike, nëpërmjet parandalimit të konfliktit mes interesave publike dhe atyre private të një zyrtari në ushtrimin e funksioneve të veta.

21.10.2. Nga hetimi administrativ në Komision, nuk ka rezultuar e provuar në asnjë rast që subjekti, në cilësinë e prokurorit, të ketë kryer veprimtari tregtare aktive, që të ketë implikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë veprimtarinë e tij si prokuror. Nuk është evidentuar asnjë fakt i vetëm që të provojë se aktiviteti tregtar i ushtruar nga shoqëria “{***}” ShPK të ketë qenë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, të ketë marrë pjesë aktive në tenderat publike apo të ketë krijuar marrëdhënie tregtare dhe financiare me subjekte që janë hetuar ose ka pasur dyshime që janë përfshirë në veprimtari kriminale, apo të ketë operuar me shoqëri tregtare, që kanë përfutur nga fondet publike, të cilat të japin indicie se veprimtaria tregtare e kësaj shoqërie të ketë ndikuar dhe të ketë implikuar veprimtarinë si prokuror në detyrë.

21.10.3. Nga hetimi administrativ në Komision, nuk ka rezultuar e provuar asnjë fakt konkret apo e dhënë, qoftë edhe e tërthortë, që subjektet tregtare, me të cilat ka ndërvepruar shoqëria “{***}” ShPK, të kenë qenë pjesë e çështjeve hetimore që janë ndjekur dhe hetuar në mënyrë aktive nga subjekti i rivlerësimit si prokuror. Po kështu, nuk është identifikuar asnjë fakt apo rrethanë që të japë të dhëna apo indicie se subjekti, në cilësinë e prokurorit, të ketë ndërhyrë apo ndikuar në veprimtarinë hetimore të kryer ndaj personave tregtarë, me të cilët ka ndërvepruar apo ka ofruar shërbime shoqëria “{***}” ShPK,

²⁵ Nenit 149/ç të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 7, pika 4, shkronja “b” e ligjit nr. 96/2016, nenit 39, pika 4 e ligjit nr. 8737/2001, si dhe ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar.

që mund të provonin se subjekti ka shkelur parimet dhe qëllimin kryesor për të cilin ligjvënësi ka miratuar kuadrin ligjor në fuqi, për papajtueshmërinë e funksionit të magjistratit, në tërësi, dhe ligjin nr. 9367/2005, i ndryshuar, në veçanti.

21.10.4. Pjesëmarrjet e tij në mbledhjet e datës 25.07.2017 dhe të datës 10.02.2019, të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë, subjekti i rivlerësimit i konsideron veprime sporadike dhe të kufizuara, që nuk provohet të kenë sjellë ndonjë pasojë, pra të kenë cenuar interesin publik apo ndonjë interes privat, si dhe nuk përbëjnë shkak të arsyeshëm ligjor për ta klasifikuar faktin në situatën e konfliktit të interesit, për sa kohë ka pasur edhe funksionin e prokurorit. Zotërimi i kuotave në këtë shoqëri tregtare nuk përbën shkelje ligjore dhe nuk vjen në kundërshtim me përcaktimet e nenit 149/ç të Kushtetutës, pasi nuk është veprimtari profesionale që ushtrohet kundrejt pagesës, dhe as me nenin 7/4/ç të ligjit nr. 96/2016. Ndalimi në këtë dispozitë lidhet dhe kufizohet, vetëm në ato raste kur shoqëria tregtare, kuotat e së cilës zotërohen nga magjistrati, krijon në mënyrë të qartë: konflikt interesi, përshtypjen se magjistrati është i njëanshëm, si dhe se magjistrati ndikohet në ushtrimin e detyrës së tij.

21.10.5. Subjekti në vijim pretendon se nuk qëndron dhe është rrjedhojë e interpretimit të ngushtë, dhe jashtë qëllimit të ligjvënësit në miratimin e këtij kufizimi, konstatimi i Komisionit se pjesëmarrja e subjektit të rivlerësimit si ortak i asamblesë, në organe drejtuese të shoqërisë, duke kryer veprime për llogari të shoqërisë, duket se bie ndesh me parashikimin e bërë në nenin 39, pika 4 e ligjit nr. 8737/2001, i ndryshuar. Ky ligj e pengon prokurorin të jetë pjesë e organeve drejtuese, por nuk e ndalon të jetë pronar i një shoqërie tregtare apo i një pjese të kuotave të saj, gjë që gjen mbështetje edhe në nenin 41 të Kushtetutës, për garantimin dhe mbrojtjen e të drejtës së pronës.

21.10.6. Ortaku i shoqërisë tregtare, sipas ligjit nr. 9901/2008, është njëkohësisht edhe anëtar i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, që është një nga organet e shoqërisë tregtare. Pjesëmarrja në këtë organ është për shkak të cilësisë së pronarit të shoqërisë apo të një pjese të kuotave të saj, ndërsa administratori emërohet kundrejt shpërblimit. Në këtë kuptim, kufizimi që ka vendosur neni 39, pika 4 e ligjit nr. 8737/2001 ka të bëjë me ndalimin e prokurorit që të jetë pjesë e organeve drejtuese të shoqërisë, i emëruar në këtë detyrë dhe për të cilën të paguhet, sikurse administratori i saj.

21.10.7. Në kushtet kur ligji nuk e ndalon prokurorin të zotërojë apo të ketë në pronësi kuota ose pjesë të kapitalit të një shoqërie tregtare, kufizimi i parashikuar në nenin 39, pika 4 e ligjit nr. 8737/2001, nenin 149/ç të Kushtetutës, si dhe nenin 7, pika 4, shkronja “b” e ligjit nr. 96/2016, nuk lidhet me ndalimin e prokurorit për të qenë pjesëtar i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, pjesëmarrja e të cilit është për shkak të ligjit, por lidhet me ndalimin e tij për të qenë administrator i shoqërisë, si në rastin kur ai është edhe ortak i vetëm apo me kuota të caktuara. Ndalimi në nenin 39, pika 4 e ligjit nr. 8737/2001, nuk duhet të merret si dispozitë e shkëputur, por duhet interpretuar në frymën dhe përmbajtjen në tërësi të të gjithë ligjit. Prokurori do të ishte në shkelje të kësaj dispozite, nëse do të merrte pjesë në organet drejtuese të shoqërive tregtare, në të cilat ai nuk zotëron asnjë kuota apo aksion.

21.10.8. Subjekti i rivlerësimit parashtron se nuk ka vepruar në kundërshtim me parimet e pavarësisë dhe paanësisë, të parashikuara nga urdhri nr. 141, datë 19.06.2014, i Prokurorit të Përgjithshëm, “Për miratimin e rregullave mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve”, apo me paragrafin 169 të Komentarit të Parimeve të Bangalores për Sjelljen Gjyqësore, titulluar “Aktivitetet financiare”. Ai ka marrë të gjitha masat për të shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e detyrës si prokuror, duke mos lejuar dhe as krijuar ndonjë dyshim, për cenim të mundshëm të pavarësisë së tij si magjistrat.

21.10.9. Në analizë harmonike të dispozitave ligjore në fuqi, subjekti vlerëson se qëllimi i ligjvënësimit për të kufizuar ushtrimin e funksionit të prokurorit ka qenë vetëm që ky i fundit të mos ketë të drejtë të marrë pjesë në mënyrë aktive në drejtimin e shoqërisë, por jo ta privojë atë nga pronësia mbi sendin. Kjo do të ishte në kundërshtim, jo vetëm me Kushtetutën dhe ligjet. Nëse do të interpretohej ndryshe, do të ishte e paarsyeshme që prokurorit t'i lejohet të mbajë në pronësi një shtëpi, dyqan, makinë, t'i japë me qira ato dhe të përfitojë të ardhura prej tyre, si dhe do të duhet që t'i ndalohej edhe mbajtja në pronësi e sendeve të tilla si kuota/aksione në shoqëri tregtare.

21.10.10. Si ligji nr. 9637/2005, që rregullon konfliktin e interesit, ashtu edhe ligji nr. 96/2016, në asnjë dispozitë të tyre, nuk pengojnë prokurorin të jetë zotërues apo të ketë në pronësi të tij kuota ose aksione në shoqëritë tregtare, në këto kushte, qenia anëtar i Asamblesë së Përgjithshme nuk buron nga dëshira e prokurorit, por është një pjesëmarrje *ipso jure*. E tillë ka qenë dhe pjesëmarrja e subjektit të rivlerësimit në mbledhjet e Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë “{***}” ShPK.

21.10.11. Vlerësimi i Komisionit, se pjesëmarrjet e subjektit në mbledhjen e Asamblesë së Ortakëve, në datën 25.07.2017 dhe datën 10.02.2019, bien në kundërshtim me ndalesën në nenin 7/4/b të ligjit nr. 96/2016, sipas subjektit, është rrjedhojë e interpretimit shumë të ngushtë dhe jo harmonik të legjislacionit të zbatueshëm. Këto pjesëmarrje nuk tregojnë zotërimin aktiv të kuotës në kapitalin themeltar të shoqërisë nga ana e magjistratit, por janë veprime që tregojnë ushtrimin e së drejtës si pronar legjitim për të përfutur frytet civile të sendit në pronësi, në kuptim të neneve 145 dhe 151 të Kodit Civil, dhe vendimmarrjet janë në përputhje me ligjin për shoqëritë tregtare.

21.10.12. Mënyra e kuptimit të ligjit dhe kufizimeve ligjore në lidhje me ushtrimin e funksionit të prokurorit ka ndikuar që subjekti të kryejë këto veprime sporadike, duke besuar fort dhe duke provuar qartësisht se nuk ka implikuar në asnjë mënyrë, rrethanë apo masë, interesat privatë me funksionin publik, korrektësinë e ushtrimit të detyrës, apo cenimin e interesit publik.

21.10.13. Marrëveshja për caktimin e personit të besuar në datën 26.03.2018, rreth 18 muaj nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 96/2016, është bërë pasi, në atë periudhë, subjekti i rivlerësimit ka vepruar *de facto* si zotërues pasiv i kuotave, duke mos marrë vendime, të cilat do të mund të konsideroheshin si disponim aktiv i kuotave të shoqërisë tregtare. Pjesëmarrja si ortak në një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar që prej vitit 2014, nuk ka ndikuar në asnjë rast në pavarësinë e tij si magjistrat, në ushtrimin e detyrës së prokurorit dhe, kjo pjesëmarrje, nuk ka qenë e ndaluar nga ligji në kohën e themelimit të shoqërisë “{***}” ShPK, ndërsa më pas është lejuar dhe rregulluar shprehimisht nga ligjvënësi, duke filluar nga viti 2016, me kufizimet përkatëse, të cilat, të analizuara si më lart, janë respektuar me synimin kryesor të mungesës së ekzistencës së konfliktit të interesit dhe moscenimit të pavarësisë në ushtrimin e detyrës. Konstatimet e Komisionit lidhen kryesisht me kuptimin dhe interpretimin e ligjit dhe, si të tilla, nuk mund të kenë efekt penalizues për subjektin, qëndrim ky që mbështetet edhe nga Kolegji në jurisprudencën²⁶ e tij. Subjekti i rivlerësimit ka marrë masa dhe ka vepruar në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi për të mënjeluar papajtueshmëritë e përcaktuara në ligj dhe masa administrative që jepet në të tilla raste duhet të jetë proporcionale, në përputhje me shkëljen e kryer, si dhe duke mbajtur në konsideratë qasjen e sjelljes së subjektit që ka kryer shkëljen.

21.11. Gjatë seancës dëgjimore të datës 10.05.2023, referuar procesverbalit të mbajtur, pas

²⁶ Shih vendimin nr. 42/2022 (JR), paragrafët 29.1 – 30, që i përket subjektit të rivlerësimit Niko Rapi, vendimin nr. 35/2021 (JR), paragrafët 23.7 – 23.9, që i përket subjektit të rivlerësimit Alkelina Gazidedja.

argumenteve të subjektit të rivlerësimit, se nuk ndodhej në situatën e papërputhshmërisë me funksionin dhe konfliktin e interesit, ndryshe nga interpretimet e avokatit,²⁷ vëzhguesja ndërkombëtare ka konstatuar se kuotat në shoqërinë “{***}” ShPK, subjekti i rivlerësimit nuk i ka trashëguar, por është ai që e ka themeluar këtë shoqëri, dhe ky fakt është i pakundërshtueshëm. Subjekti i rivlerësimit ka hyrë në treg, ka filluar aktivitetin, ka punësuar stafin, shoferët, ka gjetur financime, ka emëruar administratorët, ka shitur aksione dhe, në këndvështrim të vëzhgueses ndërkombëtare, këto veprime tregojnë angazhim të subjektit të rivlerësimit në aktivitetin tregtar të shoqërisë, dhe duket si punë me kohë të plotë, duke sjellë në vëmendje edhe konstatimin e emrit e tij në *website*-in e shoqërisë “{***}” ShPK.

21.12. Në përgjigje të këtij konstatimi, avokati i subjektit të rivlerësimit e kundërshton situatën e bërë prezente. Sipas tij, subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer asnjë nga këto veprime, të cilat janë ndërmarrë nga administratori i shoqërisë. Për sa i përket trashëgimisë së kuotave, ajo është marrë si shembull për të vërtetuar që një magjistrat mund të ndodhet i detyruar për të kryer veprime si ortak, dhe do t'i kryejë ato derisa të caktojë një person të besuar, si në këtë rast. Ndërsa, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se emri i tij nuk ka qenë ndonjëherë pikë kontakti për këtë shoqëri, por të dhënat e tij janë marrë në momentin e themelimit dhe depozitimit të dokumenteve fillestare të saj. Ai nuk është pikë kontakti, pasi shoqëria ka *website*, të dhëna, adresë, numra kontakti të administratorëve, pra ka një faqe interneti të caktuar për të publikuar veprimtarinë e saj. Subjekti në vijim thekson se shoqëria ka qenë në një zonë që ai nuk ka pasur kompetencë territoriale për të bërë hetime, pasi ai ushtron detyrën e prokurorit në Tiranë, ndërsa veprimtaria e shoqërisë është ushtruar në rrethet/zonat naftëmbajtëse, konkretisht në Fier, Vlorë dhe Mallakastër, dhe se të gjithë punonjësit janë gjetur nga administratori, i cili është një kushëri i tij.

21.13. Për sa parashtruar më sipër, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se Komisioni e ka trajtuar çështjen në kuadër të mospërputhjeve apo ndalimeve/kufizimeve për shkak të detyrës, mbështetur në legjislacionin e zbatueshëm, përpara dhe pas ndryshimeve kushtetuese dhe paketës ligjore të vitit 2016, si dhe rregullave të etikës dhe sjelljes të përcaktuara në aktet rregullatore, kombëtare dhe ndërkombëtare²⁸. Përpos kësaj, Komisioni e ka analizuar këtë çështje edhe në kuadër të konfliktit të interesit, kur shprehet se, në kuptim të nenit 5 të ligjit nr. 9367/2005, krijimi/fitimi i të ardhurave nga shpërndarja e dividendit çmohet si rrethanë që përfshihet në interesat privatë të zyrtarit, që për rrjedhojë, krijon premisë për ekzistencën e gjendjes së konfliktit të interesit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në këtë rast, të subjektit të rivlerësimit. Në kushtet kur konflikti i interesit është një koncept situacional, që analizohet kur konstatohet gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari dhe nisur nga situata faktiko-ligjore që ofrojnë aktet në dosjen gjyqësore, trupi gjykues çmon ta vlerësojë çështjen nën optikën e ndalimeve dhe kufizimeve ligjore, për shkak të funksionit të prokurorit.

21.13.1. Aktet e administruara në fashikullin e Komisionit provuan se subjekti i rivlerësimit e ushtron funksionin e prokurorit që prej datës 01.10.2001 dhe, në shkurt të vitit 2014, gjatë kohës që ushtronte këtë funksion në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, themelon dhe regjistron një

²⁷ Nga aktet në fashikullin e Komisionit, rezulton se subjekti i rivlerësimit është përfaqësuar nga avokat J. M., me licencë nr. {***}.

²⁸ “Statuti i Romës”, i vitit 2014; “Udhëzimet/normat e Budapestit mbi Sjelljen dhe Etikën e Prokurorëve Publikë”; “Standardet e Përgjegjësisë Profesionale dhe Deklarata e Detyrave dhe të Drejtave Themelore të Prokurorëve”, viti 1999.

shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, me emrin “{***}”, me seli në Vlorë, në të cilën, fillimisht, rezulton ortak i vetëm dhe, prej vitit 2015, ortak i 50% të kuotave të kapitalit të shoqërisë. Krijimi i kësaj shoqërie dhe angazhimi i subjektit të rivlerësimit në veprimtarinë e saj janë shoqëruar fillimisht me kryerjen prej tij të një sërë veprimesh në cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë, si përcaktimi dhe ndryshimi i administratorit, gjetja e mjeteve financiare nëpërmjet kontratave të kredisë me Tirana Bank ShA, për financimin e aktivitetit të kësaj shoqërie, zgjerimin e tij, ashtu edhe për hapje adrese sekondare. Krijimi i shoqërisë tregtare dhe kryerja e këtyre veprimeve nga subjekti i rivlerësimit janë ndërmarrë në një kohë që ligji në fuqi, nr. 8737/2001, i ndryshuar, në nenin 39, pika 4 e tij, parashikonte në mënyrë eksplicite ndalimin e prokurorit për të marrë pjesë në organet drejtuese të shoqërive tregtare.

21.13.2. Trupi gjykues i Kolegjit, me të njëjtin arsyetim si Komisioni, e gjen të pabazuar interpretimin që subjekti i rivlerësimit i bën dispozitave të ligjit nr. 9901/2008, natyrës së organeve drejtuese të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar apo pretendimeve të tjera, duke i vlerësuar ato më tepër si një përpjekje për të minimizuar përfshirjen e tij në ushtrimin e aktivitetit tregtar në mënyrë aktive. Fakti që ky ligj ka përcaktuar qartë cilat janë organet drejtuese të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, pra Asambleja e Përgjithshme dhe administratori, është kuptuar drejt nga subjekti i rivlerësimit në kohën e krijimit të saj, pasi në aktin e themelimit dhe statusin e shoqërisë të firmosur prej tij, në cilësinë e ortakut të vetëm, në nenin 8 janë përcaktuar organet drejtuese, Asambleja e Ortakëve dhe administratori, kompetencat dhe të drejtat e detyrimit e secilit prej organeve janë parashikuar në nenet në vijim të këtij akti. Në këtë kuptim, subjekti i rivlerësimit e ka lejuar veten të gjendet në kushtet e paligjshmërisë, duke u vendosur në situata, të cilat, që në fillim, tregojnë papajtueshmëri me funksionin e prokurorit.

21.13.3. Përpos parashikimit në ligjin organik të sipërcituar, disa muaj pas themelimit dhe regjistrimit të shoqërisë tregtare nga subjekti i rivlerësimit, në zbatim të ligjit nr. 8737/2001, Prokurori i Përgjithshëm, me urdhrin nr. 141, datë 19.06.2014, miraton rregullat mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve. Në nenin 4, shkronja “ç” e këtij akti, parashikohet se prokurorët duhet: *“Të mos zhvillojnë veprimtari ekonomike, përfshirë çdo lloj pune apo biznesi për të përfituar interesa materiale ose jomateriale, që mund të ndikojnë në pavarësinë e tyre, ose që mund të krijojnë përshtypjen e përdorimit të detyrës për interesat e tyre ose personave të tjerë, si dhe nuk duhet të anëtarësohen në organizata shoqërore, të cilat krijojnë dyshimin se komprometojnë figurën e prokurorit apo janë të papajtueshme me funksionin e tij”*. Për sa më sipër, subjekti i rivlerësimit nuk duket që, për angazhimin në këtë veprimtari tregtare, të ketë njoftuar drejtuesin e Prokurorisë së Rrethit Tiranë apo Prokurorin e Përgjithshëm, si institucionet përgjegjëse për mbikëqyrjen e veprimtarisë, statusit, sjelljes dhe karrierës së prokurorëve. Trupi gjykues nuk i gjen bindëse shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, se ai nuk mund të penalizohet për mënyrën se si i ka kuptuar dispozitat e ligjit nr. 9367/2005 dhe, nga ana tjetër, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk mund të linte pa vëmendje dispozitat e ligjit organik të prokurorisë, në drejtim të shmangies së veprimeve që ndikojnë në papajtueshmërinë me funksionin e prokurorit, dhe që mund t’i kishin dhënë zgjidhje kësaj situatë që në fillimet e saj.

21.13.4. Ashtu sikurse arsyeton edhe Komisioni në vendim, pjesëmarrja aktive e subjektit të rivlerësimit në veprimtari tregtare, përveç periudhës 2014 – 2016, ka vijuar në mospërbushje të detyrimeve të parashikuara edhe nga ligji nr. 96/2016, pas hyrjes në fuqi të tij në nëntor 2016. Analiza e veprimeve të subjektit të rivlerësimit, bazuar në provat e dala nga hetimi administrativ, e ka

ekspozuar atë në papajtueshmëri të vazhdueshme me detyrën. Më konkretisht, me vendimmarrjen e datës 25.07.2017, për miratimin e pasqyrave financiare për vitin 2016, subjekti i rivlerësimit ka vepruar si zotërues aktiv i aksioneve në kundërshtim me ndalesën e parashikuar në nenin 7, pika 4, shkronja “b” e ligjit nr. 96/2016, sipas së cilit, magjistratit i ndalohet “*të zotërojë në mënyrë aktive aksione ose pjesë të kapitalit të një shoqërie tregtare, në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit*”. Nga aktet në dosjen gjyqësore, rezultoi e provuar se subjekti i rivlerësimit priti nga muaji nëntor 2016 deri në mars 2018 për të nënshkruar marrëveshjen me personin e besuar dhe kalimin e tij në zotërues pasiv të kuotave të kapitalit të shoqërisë, në zbatim të dispozitës së sipërcituar. Subjekti i rivlerësimit ka vepruar si zotërues aktiv i kuotave të tij në këtë shoqëri, edhe pas nënshkrimit të marrëveshjes me personin e besuar, më datë 26.03.2018, pasi në datën 10.02.2019 ka marrë vendimin për shpërndarjen e fitimit për vitet 2015, 2016 dhe 2017, si dividend për ortakët, duke vepruar në kundërshtim me dispozitën e sipërcituar. Miratimi i pasqyrave financiare të shoqërisë apo disponimi mbi fitimin e realizuar nëpërmjet shpërndarjes së dividendit, tregojnë për zotërim aktiv të kuotave në shoqëri.

21.13.5. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se faktet provuese të dala gjatë hetimit administrativ treguan qartë se subjekti i rivlerësimit ka vepruar në mospërbushje të detyrimeve ligjore të magjistratit, më së paku, duke nisur nga momenti i hyrjes në fuqi të ligjit nr. 96/2016, duke anashkaluar ndalimet e shprehura qartësisht në këtë ligj nëpërmjet veprimeve aktive, duke ruajtur një pozicion me ndikim në vendimmarrje për aktivitetin e shoqërisë tregtare, të cilat të krijojnë përshtypjen se cenojnë ushtrimin e pavarur dhe të pandikuar të funksionit të subjektit të rivlerësimit si prokuror, si dhe në perceptimin që krijohet në syrin e një vëzhguesi të jashtëm për një funksionar të sistemit të drejtësisë.

21.14. Për sa më sipër, në lidhje me aksionet e subjektit të rivlerësimit në shoqërinë “{***}” ShPK, pozitën dhe rolin e tij në raport me ushtrimin e funksionit të magjistratit/prokurorit, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se zotërimi i kuotave në një shoqëri tregtare dhe pjesëmarrja e subjektit të rivlerësimit në këtë veprimtari, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 7, pika 4, shkronja “b” dhe “ç” të ligjit nr. 96/2016, e ka vendosur subjektin e rivlerësimit në mospërputhje me funksionin e tij si prokuror dhe angazhimin ndaj etikës dhe vlerave profesionale, rrethana të cilat vlerësohen në drejtim të cenimit të besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, sipas parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

22. Lidhur me kriterin e aftësive profesionale, trupi gjykues konfirmon problematikat e evidentuara nga trajtimi i denoncimeve të denoncuesve A. P., A. P. dhe D. P., të konstatuara në Komision, por nuk i vlerëson të tilla për t’u marrë në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 e, për rrjedhojë, për t’i kualifikuar sipas nenit 61, pika 5 e po këtij ligji.
23. Në përfundim, trupi gjykues në Kolegji, mbështetur në nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë e, për pasojë, çmon se vendimi nr. 659, datë 12.05.2023, i Komisionit, është i drejtë, i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 659, datë 12.05.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Sokol Malaj.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 16.07.2025, në Tiranë.

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

RELATORE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

KRYESUESE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi